



KOSOVO PROPERTY AGENCY
AGJENCIA KOSOVARE E PRONËS
KOSOVSKA AGENCIJA ZA IMOVINU

Raporti Vjetor 2012



www.kpaonline.org

*Raporti Vjetor*2012

Të drejtat e rezervuara për Agjencinë Kosovare të Pronës, (AKP), 2013.

Materialet e këtij publikimi mund të ripërdoren me kusht që të përmendet burimi kryesor i tyre.

Agjencia Kosovare e Pronës

Perandori Justinian 5

Prishtinë

Telefoni: +381 38 249 918

Telefax: +381 38 249 919

E-mail: mailbox@kpaonline.org

<http://www.kpaonline.org>



KOSOVO PROPERTY AGENCY
AGJENCIA KOSOVARE E PRONËS · KOSOVSKA AGENCIJA ZA IMOVINU
Perandori Justinian 5 - Prishtinë/Pristina
Tel +381 (0)38 249 918 · Fax +381 (0)38 249 919
www.kpaonline.org · mailbox@kpaonline.org

NË MBROJTJE TË PRONËS PRIVATE – PROTECTING PRIVATE PROPERTY – ZAŠTITA PRIVATNE IMOVINE

Raporti Vjetor

2012

e themeluar nga rregullorja e UNMIK-ut 2006/10 - established by UNMIK Regulation 2006/10 - osnovana pod UNMIK Uredbom 2006/10
e përkrahur nga - supported by - podržavaju



PËRMBAJTJA

Lista e shkurtesave
Parathënie e Kryetarit të Bordit Mbikëqyrës
Agjencia Kosovare e Pronës

Themelimi dhe mandati
Struktura organizative
Sekretaria Ekzekutive
Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës
Bordi Mbikëqyrës

Pranimi i Kërkesave dhe Informimi i Palëve

Statistikat për numrin e kërkesave të regjistruara
Njoftimi për Kërkesat
Publikimi i Kërkesave

Përpunimi i Kërkesave

Hetimi i Kërkesave
Qasja në të dhënat pronësore dhe verifikimi i dokumenteve
Hartimi i parashtrësve ligjore për Kërkesat

Vendosja e kërkesave nga Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës

Natyra e kërkesave të vendosura
Statistikat për kërkesat e vendosura
Procedurat e Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës
Natyra e vendimeve
Forma e vendimeve
Urdhrat dhe mjetet ligjore

Zbatimi

Hyrje
Shpërndarja dhe zbatimi i vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK)
Shpërndarja dhe zbatimi i aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës për ankesat ndaj vendimeve të KKPK-së.
Zbatimi i vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore
Zbatimi i skemës për kompensim
Mbyllja e rasteve

Administrimi i Pronave dhe Skema e Qiradhënies Vullnetare dhe Aktivitetet e Dëbimit

Administrimi i pronave banesore
Skema e Qiradhënies Vullnetare
Lloji dhe numri i pronave në Skemën e Qiradhënies
Aktivitetet e dëbimit
Rastet e ri-uzurpimit serik

Personeli dhe Aftësimi Profesional

Burimet Njerëzore
Menaxhmenti dhe Personeli

Financimi dhe Buxheti

Financimi
Zbatimi i Buxhetit
Vlerësimi i Donatorëve

Synimet Operative dhe Treguesit e Performancës

Plani i Punës 2012
Progresi i arritur kundrejt synimeve operative të Planit të Punës për kërkesat
Progresi i arritur kundrejt synimeve operative të Planit të Punës për pronat nën administrim

Veprimtaritë për Ndërgjegjësim dhe Komunikim si dhe Shpërndarja e Informatave për Publikun

Transparenca, ndërgjegjësimi dhe komunikimi
Bashkëpunimi në mes agjencive

Përmbledhje e Gjendjes së Kërkesave dhe Administrimit të Pronave deri më 31 dhjetor 2012.

Ngjarjet kryesore gjatë vitit 2012

SHTOJCAT

- A. Pasqyra e rrjedhës së përpunimit të kërkesave
- B. Statistikat për vendosjen e kërkesave
- C. Buxheti i AKP-së për vitin 2012
- D. Buxheti i rishikuar i AKP-së për vitin 2012
- E. Pasqyra e shpenzimeve të buxhetit të AKP-së për vitin 2012
- F. Pronat nën administrimin e AKP-së sipas rajoneve dhe komunave
- G. Organogrami i AKP-së

LISTA E SHKURTESAVE

NJPK	Njësi për Përpunimin e Kërkesave
EULEX	Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit
ABF	Anëtar i Bashkësisë Familjare
DÇPB	Drejtorati për Çështje Pronësore dhe Banesore
KKPB	Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore
PCN	Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar
PZH	Personat e Zhvendosur Brenda Vendit
AKK	Agjencia Kadastrale e Kosovës
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
AKP	Agjencia Kosovare e Pronës
KKPK	Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës
OJQ	Organizatë Jo-Qeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
Autorizim	Autorizim
BDP	Bartësi i së Drejtës Pronësore
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNHCR	Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
UNMIK	Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara për Administrim në Kosovë

PARATHËNIE

Kam kënaqësinë të paraqes Raportin Vjetor të Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP) për vitin 2012. Ky vit ka shënuar një prej ndryshimeve më të rëndësishme për Kosovën, përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur në muajin shtator dhe implikimet e saj për AKP-në. për shkak të përfshirjes së saj brenda sferës së Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit. Prandaj, është rënë dakord para përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrur, që ndërkombëtarët e emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar të vazhdojnë të punojnë në AKP deri më 31 gusht 2014, apo deri në përfundim të mandatit të AKP-së për kërkesat e paraqitura. Me qëllim të zbatimit të marrëveshjes, janë vënë dispozita në Ligjin 04/L-115 për përfundimin e Pavarësisë së Mbikëqyrur për të siguruar zëvendësimin e çdonjërit prej këtyre të emëruarve nëse ata do të largoheshin para datës 31 gusht 2014, apo para përfundimit të mandatit të AKP-së për kërkesa.

Në muajin gusht paraardhësi im Andy Sparkes u largua nga pozita e tij si Kryetar i Bordit Mbikëqyrës pas disa viteve të përkushtuara në punën dhe progresin e AKP-së. Udhëheqja këmbëngulëse e Andyt do të mungojë, por kam kënaqësinë të konfirmoj se puna dhe progresi i AKP-së i disa viteve të kaluara ka vazhduar pandërprerë përgjatë vitit 2012. Gjithashtu, isha e lumtur që pata mundësinë t'i uroj mirëseardhjen Ambasadorit Britanik në Kosovë, z. Ian Cliff, i cili në muajin gusht u caktua anëtar i ri i Bordit Mbikëqyrës. Ngjashëm, z. Ismajl Osdautaj u mirëprit në Bordin Mbikëqyrës pas emërimit të tij në muajin maj.

Sa i përket përpunimit të kërkesave, produktiviteti në rritje që ka rezultuar nga ristrukturimi i ekipit të përpunimit të kërkesave në vitin 2011 ka vazhduar të jep rezultate të mira në vitin 2012, me 11,220 kërkesa të vendosura nga Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës në vitin 2012. Kjo është më pak se 13,566 kërkesat e paraqitura në vitin 2011, por ndryshimi është llogaritur në bazë të rritjes së vazhdueshme të kompleksitetit të kërkesave kontestuese dhe jokontestuese në vitin 2012, me lëvizjen e AKP-së drejt përfundimit të misionit të saj si dhe përfundimit thelbësor në pjesën e parë të vitit, të kërkesave të ri-notifikuara, të cilat mund të përfundojnë në mënyrë të përsheptuar. Kërkesat e mbetura të ri-notifikuara, të gjitha duhet të ripërpunohen plotësisht. Si rezultat, vetëm 6,163 kërkesa të ri-notifikuara kanë mundur të paraqiten në vitin 2012, krahasuar me 9,414 në vitin 2011.

Hapa të rëndësishëm janë bërë në lidhje me njoftimin e paraqitësve të kërkesave për vendimet. Në fillim të vitit 2012, numri i vendimeve të dorëzuara ishte 16,228, ndërsa deri kah fundi i vitit janë dorëzuar 30,408 vendime. Numri i kërkesave që janë duke u zbatuar, sidoqoftë, nuk e ka përcjellë trendin e njëjtë, kryesisht për shkak të mungesës së përgjigjes nga paraqitësit e suksesshëm të kërkesave në njoftimin e AKP-së se si do të donin ata që vendimet e tyre të zbatoheshin. Me qëllim të adresimit të kësaj çështjeje, Bordi Mbikëqyrës ka aprovuar një propozim për të paraqitur një afat prej gjashtë muajsh për paraqitësit e kërkesave që të kërkojnë që pronat e tyre të administrohen nga AKP-ja, dhe mosrespektimi i këtij afati do të nënkuptonte që paraqitësve të kërkesave do t'u lejohej të kërkojnë vetëm riposëdim ose mbyllje të lëndëve. Deri në fund të vitit, AKP-ja kishte pranuar 16,014 kërkesa për zbatim që është shumë më pak se numri i vendimeve të dorëzuara, por në masë të madhe më mirë se 7,893 kërkesat për zbatim të pranuar deri në fillim të vitit 2012.

Në lidhmëni të drejtpërdrejt me kërkesat për zbatim, numri i pronave, të cilat janë marrë nën administrim, është rritur gjatë vitit 2012. Në fillim të vitit, 4,898 prona ishin nën administrim, ndërsa deri kah fundi i vitit numri i tyre arriti në 8,186, ku shumica prej tyre janë prona bujqësore. Zbatimi i vazhdueshëm i Skemës së Qirasë për tokën bujqësore është mbështetur nga OSBE, por është vërejtur ndikim i vogël në terren për sa i përket numrit në rritje të marrëveshjeve të qirasë, prandaj masa të mëtejshme do të ndërmerren në mënyrë që kjo çështje të adresohet në muajt në vazhdim.

Çështja e skemës së kompensimit, për të cilën AKP-ja si pasardhëse e DÇPB-së është përgjegjëse, mbetet sfidë e cila duhet të zgjidhet. Bordi Mbikëqyrës ka miratuar procedurat e nevojshme në mbledhjen e vet të mbajtur më 13 korrik 2011, dhe është punuar për të përcaktuar koston e saktë të skemës. Duhet të sigurohen fondet e domosdoshme, por janë planifikuar edhe takime dhe konsultime të mëtutjeshme me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave me qëllim të adresimit të kësaj çështjeje.

Në përgjithësi, suksesi i AKP-së vazhdon të varet nga aftësia e saj për të negociuar rrugën e saj në mes të dy grupeve të rrethanave të cilat nuk janë lehtësisht të pajtueshme. Nga njëra anë, natyra e punës së saj kërkon një numër të madh të personelit për të punuar në mënyrë profesionale, të vazhdueshme dhe në koordinim të ngushtë përgjatë një periudhe të zgjatur kohore, nëse AKP-ja arrin një zgjidhje efikase dhe të suksesshme të kërkesave për të cilat ekziston. Në anën tjetër, rrethanat financiare në të cilat AKP-ja ekziston, janë dhe mbeten në thelb, të pasigurta. Financimi nga Qeveria e Kosovës, përmes buxhetit të Kosovës, dhe në veçanti për mallra dhe shërbime, nuk është i mjaftueshëm për të përmbushur nevojat e AKP-së. Bilanci i financimit vjen nga një shumëllojshmëri e donatorëve ndërkombëtarë, shpesh në bazë të zotimeve afatshkurtra dhe të ndryshueshme, dhe pëderisa AKP-ja është mirënjohëse për gjithë mbështetjen që merr, duhet thënë se lloji i stabilitetit financiar që i mundëson AKP-së për të arritur qëllimet e saj, nuk arrihet lehtë. Në këto rrethana, AKP-ja ka vazhduar të fitojë dhe të meritojë njohjen që ajo ka marrë për të parën herë nga donatorët në tetor të vitit 2010, si një organizatë efikase dhe efektive, dhe kjo është një arritje e vërtetë.

Andrea Tomaszewicz
Kryetare e Bordit Mbikëqyrës
Agjencia Kosovare e Pronës
Shkurt 2013

KAPITULLI 1

AGJENCIA KOSOVARE E PRONËS

1.1 Themelimi dhe Mandati

Agjencia Kosovare e Pronës (AKP) është themeluar si Agjenci e Pavarur me shpalljen e Rregullores së UNMIK-ut 2006/10 për Zgjidhjen e Kërkesave mbi Pronën e Paluajtshme Private, Përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale. Rregullorja e UNMIK-ut 2006/10 është ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 me të njëjtin emër e cila i ka dhënë Agjencisë mandat të qartë dhe ndarje të roleve në mes tri organeve të saj kryesore, më saktë: Sekretarisë Ekzekutive, Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) dhe Bordit Mbikëqyrës. Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 është miratuar dhe ndryshuar me Ligjin e Kuvendit të Kosovës Nr 03/L-079 i cili ofron kornizën ligjore në fuqi për operacionet e AKP-së (në vijim legjislacioni në fuqi). Ligji 03/L-079 është ndryshuar pjesërisht me Ligjin 04/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që lidhen me dhënien fund të mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës. Duhet të theksohet se natyra dhe funksionimi i pavarur i Agjencisë nuk është ndryshuar nga asnjëri prej këtyre ndryshimeve legislative.

Mandati i AKP-së është të zgjidhë kërkesat pronësore dhe të drejtën e shfrytëzimit, me të drejtë ankese në Gjykatën Supreme të Kosovës, për pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, që janë rezultat i konfliktit të armatosur i cili ka ndodhur mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. Me këtë rast, AKP-ja ka pranuar mbi 42,347 kërkesa prej të cilave përafërsisht 90% janë pranuar përmes zyrave të AKP-së në Serbi.

AKP-ja ka gjithashtu mandat të merret me një numër të caktuar të aktiviteteve që ishin në mandatin e Drejtoratit për Çështje Pronësore Banesore (DÇPB) i cili ishte themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut 1999/23, mbyllja e së cilit përkon me krijimin e AKP-së. Përgjegjësitë përfshijnë zbatimin e vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore (KKPB) të cilat ishin në pritje të zbatimit dhe menaxhimin e pronave nën administrimin e DÇPB-së. Për të ushtruar këtë aspekt të mandatit të saj, AKP-ja ka marrë të drejtat, obligimet, përgjegjësitë dhe kompetencat e DÇPB-së. Gjithashtu, asetet fizike të DÇPB-së i janë transferuar AKP-së dhe një numër i caktuar i personelit të saj janë ri-caktuar në detyra të ngjashme brenda AKP-së.

1.2 Struktura Organizative

AKP-ja funksionon si organ i pavarur sipas nenit 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ndonëse Qeveria dhe Donatorët kanë rol të rëndësishëm në AKP përmes Bordit Mbikëqyrës. AKP-ja përbëhet nga tri organe kryesore, më saktë nga Sekretaria Ekzekutive, Komisioni për Kërkesa Pronësore (KKPK) quasi-judicial autonom, dhe Bordi Mbikëqyrës i cili ofron mbikëqyrje administrative, udhëheqje të përgjithshme dhe udhëzime për linjën e veprimit. Përveç kësaj, përmes zyrave të saj rajonale, AKP-ja është e pranishme në pesë rajone të Kosovës, gjithashtu edhe në Mal të Zi dhe Maqedoni. Detyrat, përgjegjësitë dhe aktivitetet e të gjitha këtyre zyrave koordinohen nga Koordinatori Rajonal i cili gjendet në ZQ të AKP-së. Ndonëse këto zyra janë përdorur fillimisht si lokacione ku është bërë pranimi i kërkesave, tani qëllimi është që këto zyra të funksionojnë si pikë kryesore ku shumica e paraqitësve të kërkesave mund të dorëzojnë dokumentacion shtesë dhe t'i marrin vendimet për kërkesat e tyre. Operacionet e AKP-së në Serbi tani janë duke u ndërmarrë nga Zyrat Pronësore të UNHCR, të cilat u themeluan pas nënshkrimit të një Memorandumi të Mirëkuptimit (MiM) ndërmjet AKP-së dhe UNHCR në Prishtinë më 19 gusht 2009. Më 19 nëntor 2012, u vazhdua MiM në mes të AKP-së dhe UNHCR-së në Prishtinë edhe për një periudhë një vjeçare.

1.2.1 Sekretaria Ekzekutive

Një nga përgjegjësitë e para të Sekretarisë Ekzekutive ishte mbledhja dhe regjistrimi i kërkesave. Pranimi i kërkesave është mbyllur më 3 dhjetor 2007, dhe pas përfundimit të regjistrimit të kërkesave të mbledhura më 29 shkurt 2008 janë paraqitur gjithsej 38,335. Pas kësaj faze, Sekretaria Ekzekutive është fokusuar në përpunimin e kërkesave të regjistruara para se ato t'i paraqiten KKPK-së. Këtu përfshihen veprimtaritë si në vijim:

- njoftimi i uzurpuesve të pronave të kërkuara dhe publikimi i kërkesave për palët e interesuara;
- publikimi i kërkesave;
- verifikimi i dokumenteve;
- mbledhja e dëshmimeve dhe mbajtja e intervistave me palët në kërkesë;
- përgatitja e dokumenteve me shkrim që kanë të bëjnë me kërkesat; dhe
- referimi i kërkesave KKPK-së për vendimmarrje.

Gjithashtu, AKP-ja ka mandatin të sigurojë zbatim efektiv të vendimeve përfundimtare të KKKP-së dhe të aktgjykimeve të Gjykatës Supreme për ankesat paraqitura. Kjo është arritur përmes mjeteve ligjore të cilat përfshijnë, por nuk janë të kufizuara në: vënien e pronës nën administrim të AKP-së, riposëdimin, konfiskimin dhe prishjen e ndërtimeve të paligjshme, ankandin, kompensimin dhe marrëveshjet e qirasë, ku të gjitha këto lehtësojnë dhe sigurojnë kthimin e pronave tek bartësit e ligjshëm të së drejtës pronësore.

Sipas Ligjit 03/L-079 (i ndryshuar), Kryeministri propozon Drejtorin dhe Zëvendës Drejtorin e Sekretarisë Ekzekutive për t'u emëruar më pas nga Kuvendi i Kosovës. Në pajtim me ndryshimet e bëra me Ligjin 04/L-115, emërimet e bëra në përputhje me Kushtetutën, vazhdojnë sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në vendimin e emërimit. Drejtori i tanishëm ekzekutiv është ri-emëruar nga PCN-ja më 29 qershor 2012 deri më 31 gusht 2014, ose deri në përfundim të mandatit të AKP-së, cilado që ndodh më herët. Në lidhje me Zëvendës Drejtorin Ekzekutiv, Kuvendi i Kosovës me propozimin e Kryeministrit ka bërë emërimin më 30 shtator 2010.

Drejtor i Sekretarisë Ekzekutive
është z. Scott Bowen;

Zv. Drejtor i Sekretarisë Ekzekutive
është z. Xhevat Azemi.

1.2.2 Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës

Komisionit i është dhënë jurisdiksioni që të vendos për kërkesat të cilat i referohen nga Sekretaria Ekzekutive. Sipas Ligjit 03/L-079 (i ndryshuar), Kryetari i Gjykatës Supreme propozon tre anëtarët e Komisionit për t'u emëruar nga Kuvendi i Kosovës. Në pajtim me ndryshimet e bëra me Ligjin 04/L-115, emërimet e bëra në përputhje me Kushtetutën, vazhdojnë sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në vendimin e emërimit. Kryetari aktual ndërkombëtar dhe anëtari ndërkombëtar i Komisionit janë ri-emëruar nga PCN-ja më 29 qershor 2012 deri më 31 gusht 2014, ose deri në përfundim të mandatit të AKP-së, cilado që ndodh më herët. Kuvendi i Kosovës me propozimin e kryetarit të Gjykatës Supreme më 15 maj 2012 ka bërë ri-emërimin e nevojshëm të Komisionerit vendor.

KKPK-ja është takuar në gjashtë raste gjatë periudhës së raportimit. Sekretaria Ekzekutive i ofron KKKP-së mbështetje administrative, teknike dhe ligjore. Në kryerjen e funksioneve të tij gjyqësore KKKP-ja e ka edhe mbështetjen ligjore dhe administrative të stafit ligjor nga EULEX-it, të cilët janë të angazhuar në Zyrën e KKKP-së.

Anëtarët e Komisionit janë:

Z. Veijo Heiskanen (Finlandë) është kryetar i Komisionit. Më parë ai ishte anëtar i Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore të Kosovës. Ka diplomuar në Universitetin e Helsinkit dhe në Shkollën Juridike të Harvardit. Para pozitës së tij në LALIVE në Gjenevë, ai ka mes tjerash ka shërbyer edhe si Sekretar i Përgjithshëm dhe Gjyqtar i Lartë i Kërkesave në Tribunalin për Zgjidhjen e Kërkesave për Llogaritë e Papërdorura në Zvicër, Zëvendës Shef i Shërbimit Ligjor të Komisionit për Kompensim të KB dhe Këshilltar Ligjor në Tribunalin e Kërkesave Iran-SHBA. Ka ligjëruar dhe ka mbajtur pozita akademike në institucione të ndryshme, përfshirë edhe në Universitetin e Helsinkit dhe Akademinë e Ligjit Ndërkombëtar në Hagë, Universitetin e Lozanës dhe Universitetin e Helsinkit. Është autor i publikimeve të shumta mbi Ligjin Ndërkombëtar; Arbitrimin Ndërkombëtar dhe zgjidhjen e kontesteve.

Z. Norbert Wühler (Gjermani) është anëtar ndërkombëtar i Komisionit. Ka diplomuar dhe mbrojtur doktoraturën në lëmin e drejtësisë në Universitetin e Heidelbergut. Ai është ish-Drejtor i Programeve për Rindërtim në Organizatën Ndërkombëtare për Migrim. Pozitat e mëparshme të tij kanë qenë: Udhëheqës i Filialit të Shërbimeve Ligjore të Komisionit për Kompensim të Kombeve të Bashkuara, Këshilltar Ligjor i Kryetarit dhe Zëvendës i Sekretarit të Përgjithshëm të Tribunalit për Kërkesa Iran-SHBA, Partner Hetimi në Institutin Max Planck për Ligjin Krahasues Publik dhe Ligjin Ndërkombëtar në Heidelberg, dhe Përfaqësues Ligjor i pranuar tek Avokatët e Heidelbergut dhe Mannheim-it. Ishte kryetar, anëtar dhe sekretar i disa gjykatave ndërkombëtare arbitrare, këshilltar i Komisionit të Kërkesave për Pronën e Paluajtshme në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Komisionit për Kërkesa Eritre-Etiopi, dhe është anëtar i Komisionit Drejtues mbi Proceset Ndërkombëtare të Kërkesave në Masë në Gjykatën e Përhershme të Arbitrimit. Ka ligjëruar dhe publikuar punime mbi kërkesat ndërkombëtare pronësore dhe për kompensim, zgjidhjen e kontesteve, dhe arbitrimin ndërkombëtar.

Z. Adem Vokshi (Kosovë) është anëtar vendor i KK-PK-së. Ka diplomuar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës në vitin 1975. Prej vitit 1975 deri më 1978 ka bërë praktikën në Gjykatën e Qarkut në Pejë dhe prej vitit 1978 deri më 1982 ka qenë gjyqtar në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë. Prej vitit 1982 deri më 2009 ka punuar si avokat në Mitrovicë, dhe ka specializuar në fushën e të Drejtave Civile dhe Administrative. Prej vitit 2004-2006 ka qenë Kryetar i Odës së Avokatëve të Kosovës. Ka ligjëruar dhe ka udhëhequr seminare mbi çështjet e ndryshme ligjore për institucionet vendore dhe ndërkombëtare përfshirë Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP), Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE), Këshillin e Evropës, Institutin Gjyqësor të Kosovës dhe Odën e Avokatëve të Kosovës. Temat e përfshira janë: mbrojtja në procedurat gjyqësore, dëshmitë, përfaqësimi i palëve në procedurat civile, ofrimi i ndihmës juridike për komunitetet e minoriteteve në Kosovë, zbatimi i procedurave kontestuese, jokontestuese dhe ekzekutive, mbrojtja e viktimave, transparenca dhe anti-korrupsioni në sistemin gjyqësor të Kosovës dhe parandalimi i krimit financiar. Ai, gjithashtu, ka udhëhequr seminare të ndryshme mbi ofrimin e ndihmës juridike falas. Prej vitit 2002 ai ligjëron procedurën civile për kandidatët që trajnohen për provimin e juridikaturës ndërsa prej vitit 2008 ligjëron procedurën civile për kandidatët që trajnohen për gjyqtarë. Z. Vokshi gjithashtu ka marrë pjesë në të gjitha juridiksionet në Kosovë, edhe në nivel të Gjykatës Komunale, Gjykatës së Qarkut dhe Gjykatës Supreme dhe është bashkautor i doracakut për provimin e jurisprudencës, i doracakut për procedurën kontestimore dhe Komentues i Ligjit të Kosovës për Familjen. Ai gjithashtu ka qenë anëtar i Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

1.2.3 Bordi Mbikëqyrës

Bordi Mbikëqyrës ka mandat për të mbikëqyrur punën e AKP-së dhe për t'i siguruar asaj mbikëqyrje administrative, udhëheqje të përgjithshme dhe udhëzime për linjën e veprimit. Megjithatë, i është ndaluar pjesëmarrja në procesin, në të cilin KKPK-ja shqyrton dhe i merr vendimet për kërkesat. Sipas Ligjit 03/L-079 (i ndryshuar), Kryeministri propozon pesë anëtarët e Bordit Mbikëqyrës për t'u emëruar më pas nga Kuvendi i Kosovës. Në pajtim me ndryshimet e bëra me Ligjin 04/L-115, emërimet e bëra në përputhje me Kushtetutën, vazhdojnë sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në vendimin e emërimit. Kryetari aktual dhe anëtarët ndërkombëtarë të Bordit Mbikëqyrës janë emëruar, ose ri-emëruar, nga PCN-ja më 22 gusht 2012 deri më

31 gusht 2014, ose deri në përfundim të mandatit të AKP për vendosjen e kërkesave, cilado që ndodhë më herët, dhe me autoritetin e vetëm për të mbikëqyrur çështjet që lidhen me mandatin e tanishëm të AKP-së. Në lidhje me anëtarët vendorë të Bordit Mbikëqyrës, me propozim të Kryeministrit, Kuvendi i Kosovës ka ri-emëruar një anëtar vendor dhe ka emëruar një anëtar të ri vendor të Bordit Mbikëqyrës.

Anëtarët e Bordit Mbikëqyrës janë:

Znj. Andrea Tomszewicz, gjithashtu e emëruar edhe si Kryetare e Bordit;
Z. Ian Cliff;
Z. Ismajl Osdautaj;
Z. Markus Baechler;
Z. Ujup Krasniqi.

Bordi Mbikëqyrës është takuar në pesë raste gjatë periudhës së raportimit, si dhe në dy raste të tjera për shkak të mos-emërimit të anëtarëve vendorë mbledhjet janë mbajtur nën patronazhin e një takimi të donatorëve.

Drejtori Ekzekutiv i Sekretarisë Ekzekutive e përfaqëson Sekretarinë Ekzekutive para Bordit Mbikëqyrës dhe Sekretaria Ekzekutive i ofron shërbime të sekretarisë Bordit Mbikëqyrës. Këtu përfshihen; organizimi i takimeve, përgatitja e rendit të ditës për takime dhe procesverbali i takimeve, shpërndarja e dokumenteve relevante, si dhe informatat dhe monitorimi i veprimeve pasuese në lidhje me udhëzimet e pranuar.

KAPITULLI 2

PRANIMI I KËRKESAVE DHE NJOFTIMI I PALËVE

2.1 Statistikat për Numrin e Kërkesave të Regjistruara

Në datën e mbylljes së pranimi të kërkesave, më 3 dhjetor 2007, ishin të regjistruara rreth 38,335 kërkesa. Gjatë përpunimit të kërkesave ishte zbuluar që një numër i kërkesave, të cilat ishin paraqitur si kërkesa individuale për ngastra të shumëfishta dhe të cilat në kohën e paraqitjes ishin përshkruar si afër njëra-tjetrës apo të ngjitura, në fakt ishin tërësisht të ndara, fakt ky që është zbuluar vetëm pas notifikimit të vet kërkesave, për të cilat kërkohej identifikimi dhe inspektimi i ngastrës/ngastrave në fjalë. Si rezultat, deri në përfundimin e periudhës së raportimit, numri i kërkesave të regjistruara është rritur për 660 dhe ka arritur në 42,347. Megjithatë rritja e numrit nuk përfshin kërkesa të reja të paraqitura pas mbylljes së afatit, por vetëm ndarjen dhe ri-regjistrimin e kërkesave tashmë të paraqitura.

Rreth 37,474 kërkesa (88.5% nga numri i përgjithshëm i pranuar) kanë të bëjnë me tokën bujqësore, ndërsa 851 kërkesa (2.2%) kanë të bëjnë me pronat komerciale, dhe 3,922 (9.3%) kanë të bëjnë me pronën banesore. Në 98,8% të kërkesave, paraqitësit e kërkesave kërkojnë të drejtën e pronësisë në pronën e kërkuar. Numri më i madh i kërkesave të paraqitura ka të bëjë me pronat të cilat gjenden në rajonin e Pejës (34.4%). Tabelat e mëposhtme paraqesin natyrën, ndarjen gjeografike dhe numrin e kërkesave të paraqitura.

NATYRA E TË DREJTËS SË KËRKUAR PRONËSORE

Rajoni/Kategoria	Gjilan	Mitrovicë	Pejë	Prishtinë	Prizren	Gjithsej	% e Kërkesave
Pronësia	9264	4577	14435	7013	6551	41840	98.8
Të Drejtat për Shfrytëzim	47	66	139	181	74	507	1.2
Kompensimi	0	0	0	0	0	0	0
Gjithsej	9311	4643	14574	7194	6625	42347	100
% e Përgjithshme e Kërkesave	22.0	11.0	34.4	17.0	15.6	100	100

KLASIFIKIMI I PRONAVE

Rajoni/Lloji i pronës	Gjilan	Mitrovicë	Pejë	Prishtinë	Prizren	Gjithsej
Banesore						
Komerciale me ndërtesa	107	120	267	350	107	951
Bujqësore	8519	4095	12872	6007	5981	37474
Gjithsej	9311	4643	14574	7194	6625	42347
% e Përgjithshme e Kërkesave	22.0	11.0	34.4	17.0	15.6	100

Komuna	Të paraqitura	%
Deçan	722	1.71
Dragash	6	0.01
Ferizaj	3137	7.41
Fushë Kosovë	391	0.92
Gjakovë	756	1.79
Gjilan	1706	4.03
Glllogofc	59	0.14
Istog	5923	13.99
Kaçanik	245	0.58
Kamenicë	1509	3.56
Klinë	3631	8.57
Leposaviq	75	0.18
Lipjan	1555	3.69
Malishevë	585	1.38
Mitrovicë	619	1.46
Novobërdë	881	2.08
Obiliq	451	1.07
Pejë	3542	8.36
Podujevë	2107	4.98
Prishtinë	2382	5.62
Prizren	3579	8.45
Rahovec	612	1.45
Shtërpce	126	0.30
Shtime	249	0.59
Skenderaj	1774	4.19
Suharekë	1843	4.35
Viti	1707	4.03
Vushtrri	1738	4.10
Zubin Potok	332	0.78
Zveçan	105	0.25
Gjithsej të Paraqitura	42347	100.00

2.2 Njoftimi për Kërkesat

Njoftimi për kërkesat është punë e cila mbikëqyret nga Njësi i Informimit dhe kryhet nga personeli i Zyrave Rajonale. Dispozitat e legjislacionit në fuqi e trajtojnë dhe rregullojnë pjesëmarrjen e palëve dhe sigurojnë që procedurat përkatëse të procedimit të kërkesave dhe vendimmarrja mbi kërkesat të përmbushin standardet e kërkuara të procesit të rregullt dhe procedurave të paanshme. Legjislacioni në fuqi paraqet hapat proceduralë të cilët duhet të ndërmerren për të siguruar që palët të cilat kanë interes ligjor në pronën e kërkuar të njoftohen për kërkesën dhe t'u ofrohet mundësia për të marrë pjesë në procedura. Kjo qasje është kryesorja gjatë procesit, duke ditur që për kërkesat vendoset bazuar në parashtrësat me shkrim dhe zakonisht palët nuk kanë mundësi të prezantojnë dëshmi apo argumente gojore para KKPK-së.

Nga Sekretaria Ekzekutive kërkohet që të njoftojë dhe t'i dërgojë kopjen e kërkesës çdo personi të ndryshëm nga paraqitësi i kërkesës i cili ushtron apo pretendon të drejtë në pronën e cila është lëndë e kërkesës, dhe të bëjë përpjekje të arsyeshme për të njoftuar çdo person i cili mund të ketë interes ligjor në pronë. Palët e njoftuara kanë të drejtë të përgjigjen në kërkesë dhe të paraqesin shkrësat apo të prezantojnë dëshmitë në lidhje me kërkesën.

Palët njoftohen përmes vendosjes fizike të formularit të njohur si 'njoftimi për kërkesën' në pronën e kërkuar, ose përmes publikimit në gazetën e notifikimeve të AKP-së, i cili jep detajet e kërkesës dhe natyrën e të drejtës së kërkuar pronësore. Bashkë me njoftimin për kërkesën gjendet edhe njoftimi për pjesëmarrjen përmes të cilit njoftohen palët për të drejtën e tyre për të marrë pjesë në procedurë duke plotësuar këtë formular dhe duke e paraqitur atë në AKP brenda tri-dhjetë (30) ditësh apo përndryshe duke u paraqitur personalisht në zyrën e AKP-së për t'i dhënë këto informata.

Kur personi i cili ka interes ligjor në kërkesë nuk e ka marrë njoftimin për kërkesën, rregullat e procedurës parashohin që ai apo ajo mund të pranohet si palë në çdo fazë të procedurës, nëse kërkesa nuk është vendosur nga KKPK-ja.

2.3 Publikimi i Kërkesave

Publikimi i kërkesave është gjithashtu punë që e kryen Njësi i Informimit. Procedura e publikimit përfshinë publikimin zyrtar të regjistrit me të gjitha kërkesat e paraqitura në AKP, në buletinin e njohur si Gazeta e AKP-së, e cila përmban adresën e pronës për të cilën është paraqitur kërkesa së bashku me numrin e kërkesës. Gazeta shpërndahet si shtojcë e një gazete në gjuhën shqipe në 10,000 kopje. Gazeta siguron që detajet e të gjitha pronave të kërkuara të arrijnë tek palët e interesuara dhe palët e mundshme përgjegjëse brenda dhe jashtë Kosovës. 5,000 kopje tjera në gjuhën shqipe dhe serbe në mënyrë të rregullt shpërndahen në të gjitha komunat, gjykatat, enklavat, organizatat për PZh-të dhe OJQ-të në tërë Kosovën. AKP-ja nuk mund të nxjerrë Gazetën e saj në Serbi dhe prandaj për të siguruar që informacioni shkon tek ata persona që duhet të jenë të informuar për ekzistimin e kërkesave, rreth 3.500 kopje të Gazetës së Zyrave Pronësore të UNHCR-së e cila përmban të njëjtat informacione si Gazeta e AKP-së shpërndahen përmes Zyrave Pronësore të UNHCR-së në Serbi. Gazeta gjithashtu publikohet edhe në ueb faqen e AKP-së.

Gjatë periudhës së raportimit nuk është publikuar asnjë kërkesë sepse AKP-ja ka vendosur të shtyjë publikimin e fundit të kërkesave derisa të ndahen të gjitha kërkesat që duhet ndarë.

KAPITULLI 3

PËRPUNIMI I KËRKESAVE

3.1 Shqyrtimi i Kërkesave

Shqyrtimi i kërkesave nga Sekretaria Ekzekutive përfshinë hetimin e plotë të kërkesave, verifikimin e dëshmimeve, dokumentuese të paraqitura si mbështetje, dhe hartimin e parashtresave ligjore, të cilat përmbajnë vlerësim ligjor, si dhe rekomandimin për secilën kërkesë. Procesi i verifikimit bëhet nga personeli i zyrës rajonale nën mbikëqyrjen e Njësitit për Verifikimin e Dokumenteve.

Shqyrtimi dhe përpunimi i kërkesave është i natyrës hetuese duke ditur që dëshmitë gojore zakonisht nuk mund të jepen para KKKP-së dhe procesi i vendimarrjes është i pakundërshtueshëm. Zyrtarët e Sekretarisë të përfshirë në përpunimin e kërkesave nuk janë të kufizuar në informacionet apo dokumentet e paraqitura nga paraqitësit e kërkesave. Ata mund të kontaktojnë palët në kërkesë kur nevojiten informata shtesë dhe mund të ndërmarrin çdo hetim tjetër, *ex officio* kur është e nevojshme, për të vërtetuar të gjitha faktet relevante që kanë të bëjnë me kërkesën.

3.2 Qasja në të Dhënat Pronësore dhe Verifikimi i Dokumenteve

Hulumtimi i plotë i të gjitha burimeve efikase të dëshmimeve dokumentuese mbi të drejtat pronësore është shumë i rëndësishëm në përcaktimin e saktë të së drejtës pronësore. Kështu që, njëri ndër hapat e parë thelbësor të përfshirë në përpunimin e kërkesave përfshin zyrtarët e Sekretarisë Ekzekutive që tentojnë të verifikojnë dokumentet e paraqitura në mbështetje të kërkesave, apo të bëjnë hulumtime *ex officio* në të dhënat pronësore publike në rastet kur paraqitësit e kërkesave nuk kanë ofruar dëshmi të mjaftueshme dokumentuese.

Deri më tani, sa i përket qasjes në dokumentet brenda territorit të Kosovës, dispozitat e legjislacionit në fuqi parashohin që Sekretaria Ekzekutive të ketë qasje të lirë dhe të hapur në të gjitha të dhënat. Në mënyrë të njëjtë, gjithashtu, edhe KKKP-ja ka qasje të lirë në të gjitha të dhënat në Kosovë të cilat janë të rëndësishme për zgjidhjen e kërkesës apo për çdo proces tjetër të verifikimit. Në lidhje me këtë më 13 korrik 2009 AKP-ja dhe AKK-ja kanë nënshkruar MiM-në ashtu që AKP-së i është aprovuar qasje e lirë në të dhënat e AKK-së.

Qasja në të dhënat pronësore në Serbi është gjithashtu shumë e rëndësishme për verifikimin e kërkesave, duke ditur që një pjesë e konsiderueshme e të dhënave pronësore nga Kosova gjenden atje. Pas mbylljes së zyrave të AKP-së në Serbi, qasja e papenguar të cilën AKP-ja e gëzonte më herët në arkivat pronësore të zhvendosura atje gjithashtu është anuluar. Me hapjen e Zyrave Pronësore të UNHCR-së në Serbi është rikthyer qasja në këto arkiva.

3.3 Përpilimi i Parashtresave Ligjore për Kërkesat

Pasi që kërkesa të jetë regjistruar dhe dokumentacioni mbështetës të jetë verifikuar për vërtetësinë e tij, kërkesa shqyrtohet nga zyrtarët ligjorë në Njësitin për Përpunimin e Kërkesave (NJPK), të cilët përgatisin parashtresat ligjore të cilat përmbajnë vlerësimin e kërkesës dhe rekomandimet nëse kërkesa duhet të aprovohet, të refuzohet apo të hidhet poshtë. Të gjitha detajet thelbësore, sa i përket kërkesës, shtjellohen në parashtresat ligjore të cilat pastaj i prezantohen KKKP-së së bashku me dosjen e lëndës. Kjo bëhet sipas kriterëve të Legjislacionit në fuqi, i cili parashihet rolin e Sekretarisë Ekzekutive në përgatitjen e “*parashtresave dhe dëshmimeve, përkthimit të dëshmimeve dhe rekomandimeve në lidhje me të gjitha kërkesat*” për KKKP-në.

Parashtresat ligjore përgatiten në formatin standard në dokumentin e njohur si ‘raporti i përpunimit të kërkesës.’ Modelet elektronike të raportit të përpunimit, që përdoren, përmbajnë faktet kryesore dhe bazën ligjore të kërkesës, të drejtën e pohuar pronësore dhe çdo dëshmi dokumentuese që mbështet kërkesën. Raporti është krijuar që të përfshijë detajet për çështjet kryesore ligjore dhe faktike të ngritura nga palët në kërkesë dhe paraqet detajet në lidhje me njoftimin e palëve të prekura nga kërkesa, dokumentet ligjore të paraqitura nga palët, natyrën e verifikimit të bërë dhe nëse është paraqitur më shumë se një kërkesë për pronën e kërkuar. Kur ndërtesat apo objektet në pronë janë të shkatërruara, kërkohet që raporti të paraqesë këtë fakt dhe të përmbajë një përshkrim të shkurtër të gjendjes aktuale të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës zotëron objektin/ objektet e shkatërruar/a, dhe token në të cilën gjendej ai, dhe nëse aktualisht është i uzurpuar apo është duke u shfrytëzuar për ndonjë qëllim.

KKPK-ja në asnjë mënyrë nuk është i kufizuar nga rekomandimi i raportit të përpunimit të kërkesës. Përmes një apo më shumë anëtarëve të tij, ai bën shqyrtim të pavarur të dëshmive dokumentuese. Merr vendim përfundimtar për secilën kërkesë, pas shqyrtimit të rekomandimeve nga raporti dhe bazuar në vlerësimin e vet të pavarur të çështjeve.

KKPK-ja ndihmohet në punën e tij nga Zyra e KKPK-së e cila përbëhet nga personeli juridik, administrativ dhe gjuhësor, dhe i cili i ofron përkrahje juridike, administrative dhe logjistike KKPK-së. Zyra e KKPK-së vepron nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komisionit dhe mban kontakte me Komisionerët, bën kontrollin e kualitetit të kërkesave të paraqitura Komisionit nga Sekretaria Ekzekutive para seancave të Komisionit, bën hulumtime ligjore, si dhe i përgatit draft-vendimet për nënshkrim nga Kryetari i Komisionit. Përgatitja e vendimeve të individualizuara për paraqitësit e kërkesave, palët përgjegjëse dhe palët tjera në bazë të vendimeve grupore, gjithashtu bëhet nga Zyra e KKPK-së.

KAPITULLI 4

VENDOSJA E KËRKESAVE NGA KOMISIONI PËR KËRKESA PRONËSORE I KOSOVËS

4.1 Natyra e Kërkesave të Vendosura

Komisioni ka mbajtur gjashtë seanca gjatë periudhës së raportimit, duke vendosur mbi 5,057 kërkesa të reja dhe 6,163 kërkesa të shfuqizuara më parë. 999 prej kërkesave të reja janë kontestuar nga uzurpuesit/palët përgjegjëse të cilët janë paraqitur në zyrën e AKP-së pasi që prona ishte notifikuar dhe publikuar. KKPK-ja ka rritur dukshëm numrin e vendimeve të lëshuara për kërkesat kontestuese në krahasim me periudhën e mëparshme të raportimit. Ky është rezultat i ristrukturimit të Njësitit për Përpunimin e Kërkesave në dy ekipe, njëri ekip merret me kërkesat jokontestuese dhe të shfuqizuara kurse tjetri që përmban më shumë zrytarë të lartë ligjore ka për detyrë të përpunojë kërkesat kontestuese që janë mjaft të ndërlikuara dhe ligjërishit sfiduese.

Konfirmimi i të drejtës pronësore nuk është gjithmonë i mjaftueshëm për t'iu kthyer posedimin e pronës paraqitësve të suksesshëm të kërkesave kur prona është e uzurpuar në mënyrë të paligjshme. KKPK-ja, kur e konfirmon të drejtën pronësore, mund të urdhërojë gjithashtu riposedimin e pronës në favor të paraqitësit të kërkesës dhe të japë edhe urdhra tjerë pasues nëse e sheh të nevojshme për t'ia mundësuar bartësit të së drejtës pronësore të ushtrojë të drejtën e tij/saj pronësore. Prandaj, KKPK-së në mënyrë të qartë i janë dhënë kompetencat për të siguruar pajtueshmëri me detyrimet ligjore të vendimeve në favor të bartësve të së drejtës pronësore/pronarëve.

Kjo është e rëndësishme duke pasur parasysh faktin që edhe nëse kërkesa është e pakontestuar, kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht që prona nuk shfrytëzohet apo nuk është e uzurpuar në mënyrë të paligjshme; mund të jetë edhe kjo, por edhe kur uzurpuesi nuk dëshiron të marrë pjesë, për çfarëdo arsye, në procedurë. Më tej, në rastet kur prona e kërkuar nuk duket se është e uzurpuar në kohën e notifikimit, kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht që prona më herët nuk ka qenë e uzurpuar në mënyrë të paligjshme, apo nuk do të uzurpohet në mënyrë të paligjshme në të ardhmen. Kështu që, në rastet kur prona është e pakontestuar në ditën e lëshimit të vendimit, urdhri i Komisionit, i cili konfirmon të drejtën dhe urdhëron riposedimin që përfshin edhe dëbimin e uzurpuesve të paligjshëm,

mbron të drejtën pronësore të paraqitësit të kërkesës në skenarë të tillë të mundshëm.

Si rezultat i mosbesimit ndëretnik, i cili mbizotëron në Kosovë, shumë minoriteteve iu mungon besimi në institucionet publike. Në këto rrethana, vendimi i KKPK-së, edhe kur prona nuk është e uzurpuar në mënyrë të paligjshme, konsiderohet nga bartësit e të drejtës pronësore si siguri për interesat e tyre në pronë, në rast të ballafaqimit me ndonjë pasiguri, të cilën do ta zbulonin dhe e cila do t'i dëmtonte sa i përket ndërhyrjeve në të dhënat publike pronësore. Gjithashtu, duke ditur që shumë paraqitës të kërkesave nuk mund të kenë qasje në pronat e tyre, vendimi i cili konfirmon të drejtën pronësore të paraqitësit të kërkesës, ka funksion të rëndësishëm pasi që sqaron dhe konfirmon situatën aktuale ligjore, në veçanti në rrethanat ku paraqitësit e kërkesës mund të kenë humbur dokumentet e tyre të pronësore, apo kur ato u janë shkatërruar në rrethanat e krijuara nga konflikti.

4.2 Statistikat për Kërkesat e Vendosura

11,222 kërkesa të vendosura nga KKPK hyjnë në kategoritë në vijim:

Kategoria e Kërkesave	Numri i Kërkesave të reja të vendosura	Numri i kërkesave të rivendosura
<i>Tokë bujqësore</i>	4,113	5,750
<i>Pronë komerciale</i>	183	
<i>Pronë banesore</i>	761	413
Gjithsej	5,057	6,163

4.3 Procedurat e Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës

Selia e KKPK-së gjendet në Prishtinë, dhe atij i është lejuar të ushtrojë funksionet e veta vendimmarrëse përmes seancave të mbajtura në Prishtinë apo gjetiu, apo t'i mbajë shqyrtimet përmes mjeteve elektronike kur është e nevojshme. Seancat mbahen në baza

dy-mujore. Gjuhët zyrtare të KKPK-së janë gjuha shqipe, angleze dhe serbe, por gjuha që përdoret në punën e Komisionit është gjuha angleze me përkthimet e ofruara sipas nevojës.

Kryetari i KKPK-së, në konsultim me anëtarët tjerë të Komisionit, përcakton rregullin në të cilin kërkesat duhet të referohen për vendimmarrje, gjithnjë dhe duke marr parasysh informatat në lidhje me volumin e punës të ofruar nga Drejtori i Sekretarisë Ekzekutive. Kërkesat në të cilat ngrihen çështje të njëjta ligjore dhe evidentuese futen në pako së bashku në kategoritë për vendimmarrje dhe deri më tani, në përputhje me udhëzimet e Komisionit, Sekretaria Ekzekutive i ka referuar kërkesat në pakot me çështje lëndore si në vijim:

Prona Bujqësore

- i. Kërkesat në të cilat paraqitësi i kërkesës ishte Bartës i së Drejtës Pronësore (BDP)
- ii. në datën e humbjes dhe ende është BDP;
- iii. Kërkesat e paraqitura nga Anëtarët e Bashkësisë Familjare (ABF) ku BDP-ja është ende gjallë apo ku vdekja e tij/saj nuk është dëshmuar; dhe BDP-ja ishte BDP gjithashtu edhe në datën e humbjes;
- iv. Kërkesat e paraqitura nga bartësi i Autorizimit kur BDP-ja është ende gjallë;
- v. Kërkesat ku paraqitësi i kërkesës nuk ishte BDP në datën e humbjes por është BDP aktual;
- vi. Kërkesat ku paraqitësi i kërkesës është ABF i BDP-së së ndjerë (vdekja e të cilit mund të dëshmohet) por nuk është pronar aktual i pronës; dhe kërkesa qëndron të aprovohet në emër të të ndjerit;
- vii. Kërkesat për t'u hedhur poshtë;
- viii. Kërkesat kontestuese;
- ix. Prona bujqësore: e drejta e shfrytëzimit;
- x. Kërkesa tjera kontestuese;
- xi. Kërkesat kontestuese për t'u hedhur poshtë.

Prona Banesore

- i. Kërkesat ku paraqitësi i kërkesës ishte BDP në datën e humbjes dhe ende është BDP;
- ii. Kërkesat e paraqitura nga ABF-ja/bartësi i Autorizimit dhe BDP-ja është ende gjallë apo kur vdekja e tij/saj nuk është dëshmuar; dhe BDP-ja ishte BDP gjithashtu edhe në datën e humbjes;
- iii. Kërkesat ku paraqitësi i kërkesës nuk ishte BDP në datën e humbjes por është pronar aktual;
- iv. Kërkesat ku paraqitësi i kërkesës është ABF i BDP-së së ndjerë por nuk është pronar aktual i pronës; dhe kërkesa qëndron të aprovohet në emër të të

ndjerit;

- v. Kërkesat ku prona në fjalë është e shkatërruar dhe paraqitësi i kërkesës ishte BDP në datën e humbjes dhe ende është BDP;
- vi. Kërkesat për t'u hedhur poshtë;
- vii. Kërkesat kontestuese;
- viii. Kërkesa tjera kontestuese;
- ix. Kërkesat kontestuese për t'u hedhur poshtë;
- x. Kërkesat ku prona në fjalë është e shkatërruar dhe kërkesa është paraqitur nga ABF-ja/bartësi i Autorizimit dhe BDP-ja ende është gjallë apo vdekja e tij/saj nuk është dëshmuar; dhe BDP-ja ishte BDP gjithashtu edhe në datën e humbjes;
- xi. Kërkesat ku prona në fjalë është e shkatërruar dhe paraqitësi i kërkesës nuk ishte BDP në datën e humbjes por është pronar aktual;
- xii. Kërkesat ku prona në fjalë është e shkatërruar dhe paraqitësi i kërkesës është ABF i BDP-së së ndjerë por nuk është pronari aktual i pronës, dhe kërkesa qëndron të aprovohet në emër të të ndjerit;
- xiii. Kërkesat ku prona në fjalë është e shkatërruar dhe kërkesa qëndron të hidhet poshtë;
- xiv. Prona banesore - e drejta e shfrytëzimit;

Prona Komerciale

- i. Kërkesat e kontestuar;
- ii. Kërkesat ku prona në fjalë nuk është e shkatërruar;
- iii. Kërkesat ku prona në fjalë është e shkatërruar;
- iv. Kërkesat për t'u hedhur poshtë;
- v. Prona Komerciale - e drejta e shfrytëzimit;
- vi. Kërkesat kontestuese për t'u hedhur poshtë.

Si rregull i përgjithshëm, KKPK-ja vendos mbi kërkesat bazuar në shkresat dhe dëshmitë dokumentuese. Prandaj, palët i paraqesin KKPK-së dëshmitë dhe argumentet e tyre përmes Sekretarisë Ekzekutive dhe kanë të drejtë të dinë për dëshmitë dhe shkresat e palëve tjera, dhe të paraqesin dëshmi dhe shkresa si përgjigje. Palët nuk kanë të drejtë të paraqesin dëshmi gojore derisa nuk ftohen të bëjnë një gjë të tillë, pasi që organizimi për pjesëmarrjen e disa mijëra paraqitësve të kërkesave do të shkaktonte harxhime të konsiderueshme të buri-meve dhe humbje kohe, në këtë mënyrë do të ishte në kundërshtim me të drejtat e paraqitësve të kërkesave për mjete ligjore brenda një periudhe të arsyeshme kohore. Gjithashtu, fakti që paraqitësit e kërkesave janë të zhvendosur kudo nëpër Serbi, Maqedoni, Mal të Zi dhe më larg, potencialisht do të rezultonte me atë që vetëm disa paraqitës të kërkesave do ta kishin të mundur të ushtronin të drejtën për të marrë pjesë në seanca dëgjimore. Megjithatë, duhet pasur parasysh se aty ku interesi i drejtësisë kërkon një gjë të tillë, KKPK-ja

mban seanca dëgjimore për të gjitha palët e përfshira, përfshirë këtu paraqitësit e kërkesave dhe dëshmitarët.

Gjatë periudhës së raportimit janë mbajtur dy seanca dëgjimore. Të gjitha kërkesat, janë vendosur bazuar në dosjen e kërkesës duke ju referuar KKPK-së, e cila përmban dëshmitë dhe shkresat e paraqitësit të kërkesës dhe në kërkesa të kontestuara dëshmitë dhe shkresat e palës përgjegjëse, dëshmitë e mbledhura nga Sekretaria Ekzekutive dhe raportin për përpunimin e kërkesës.

Gjatë procesit të vendimmarrjes, kur KKPK-ja konstaton se i nevojiten informata shtesë për të vendosur për çështjet e ngritura nga kërkesa, mund t'ia kthejë kërkesën Sekretarisë Ekzekutive me urdhrin që të ndërmarrë hetime shtesë në lidhje me kërkesën. Kjo zakonisht përfshin verifikime shtesë dhe hulumtime për dokumente apo intervistimin e palëve në kërkesë.

Para se të vendoset kërkesa, KKPK-ja mund, me kërkesë të paraqitësit të kërkesës dhe me rekomandimin e Sekretarisë Ekzekutive, të aprovojë masa të përkohshme të mbrojtjes, përfshirë urdhër të përkohshëm kur paraqitësi i kërkesës e ka dëshmuar *prima facie* kërkesën dhe nëse këto masa të përkohshme nuk do të aprovoheshin, do të ballafaqohej me dëme të pariparueshme.

Pas çdo seance, KKPK lëshon Udhëzimet e Përpunimit të cilat ofrojnë udhëzime për Sekretarisë Ekzekutive në lidhje me prezantimin e duhur të kërkesave për vendimmarrje nga ana e KKPK-së. Udhëzimet e përpunimit merren me çështjet procedurale dhe qenësore që dalin gjatë rrjedhës së përpunimit të kërkesave.

4.4 Natyra e Vendimeve

Komisioni mund të aprovojë, refuzojë apo hedh poshtë kërkesën apo të lëshojë ndonjë vendim apo urdhër i cili është i nevojshëm për ta zbatuar ligjin në fuqi, përfshirë urdhrat për kthimin e të drejtave pronësore dhe ri-posedimin e pronës.

Kërkesa mund të hidhet poshtë apo refuzohet tërësisht apo pjesërisht kur:

- paraqitësi i kërkesës ka dështuar të paraqesë kërkesë të plotë në përputhshmëri me procedurat e vendosura;
- kërkesa nuk është në kompetencë të AKP-së;
- kërkesa është shqyrtuar më parë dhe për të është vendosur me vendim administrativ apo gjyqësor

të formës së prerë.

Vendimet e Komisionit janë ligjërisht detyruese, pa cenuar të drejtën e ankesës në Gjykatën Supreme të Kosovës, si parashihet me Legjislacionin në Fuqi, i cili parasheh gjithashtu llojin e urdhrave që KKPK-së i lejohet t'i lëshojë. Në vendimin e tij KKPK-ja mund:

- të vendosë të drejtat e tilla pronësore të cilat janë të nevojshme për zgjidhjen e kërkesës;
- të urdhërojë posedimin e pronës në favor të çdo pale; të refuzojë apo hedhë poshtë kërkesën për çdo arsye; apo
- të anulojë çdo marrëveshje për qiranë në lidhje me pronën e cila është lëndë e urdhrit të lëshuar nga KKPK-ja, dhe të lëshojë urdhra ndihmës të cilët ndikojnë në këtë anulim.

Kur kërkesa të jetë paraqitur nga anëtari i familjes së bartësit të së drejtës pronësore, KKPK-ja mund të vendosë për çdo të drejtë pronësore në emër të bartësit të së drejtës pronësore, dhe të urdhërojë ri-posedimin në favor të paraqitësit të kërkesës.

Në rastet kur ka bashkë-pronarë, vendimi i KKPK-së konfirmon të drejtën pronësore në favor të bartësit të së drejtës pronësore në lidhje me pjesën përkatëse mbi të cilën ai gëzon të drejtën pronësore (p.sh. $\frac{1}{2}$, $\frac{1}{4}$, etj.), siç përcaktohet në dokumentet përkatëse pronësore të paraqitura nga paraqitësi i kërkesës (d.m.th. Fle-ta Poseduese, Vendimi i Trashëgiminë, Vendimet e Gjykatës, etj.). Në të gjitha rastet, vendimi i KKPK-së në mënyrë të qartë konfirmon që në rastet kur ka më shumë se një pronar, urdhri nuk ndikon në të drejtat e bashkë-pronarëve.

4.5 Forma e Vendimeve

Sipas legjislacionit në fuqi kërkohet që vendimet e KKPK-së të përmbajnë arsyetimin dhe të jenë me shkrim, duke cekur faktet materiale dhe të drejtat pronësore të konstatuara nga KKPK-ja. Kërkohet që ato të jenë të nënshkruara nga Kryetari i KKPK-së dhe të përmbajnë detajet thelbësore si në vijim:

- datën e miratimit;
- emrat e palëve dhe përfaqësuesve të tyre;
- arsyet për vendimin (përfshirë faktet materiale dhe të drejtat pronësore të cilat është konstatuar se ekzistojnë); dhe
- të përmend Urdhrat e KKPK-së.

Deri më tani, sa i përket marrjes së vendimeve, legjislacioni në fuqi parasheh që vendimet të merren në mënyrë unanime, por kur nuk mund të arrihet konsensus, kërkesa mund të vendoset me shumicë votash. Përveç kësaj, me qëllim që të lejohej zgjidhja e shpejtë e kërkesave, KKPK-ja përdor metodat, të cilat i lejojnë të lëshojë një vendim për pakot me kërkesat nga të cilat rrjedhin çështje të ngjashme ligjore, i njohur si “Vendim Grupor”.

Kryetari, duke nënshkruar Vendimin Grupor, aprovon të gjitha vendimet individuale të identifikuara dhe regjistruara me numër të kërkesës në Vendimin Grupor. Gjatë periudhës së raportimit, KKPK-ja ka lëshuar 46 Vendime Grupore, duke përfshirë 5,057 kërkesa të reja dhe 6,163 kërkesa të shfuqizuara më parë.

Kur kërkesa të jetë vendosur me Vendim Grupor, që të jetë e qartë për palët, përgatitet vendimi individual për secilën kërkesë i cili thekson detajet e pronës individuale të paraqitësit të kërkesës dhe ndihmën ligjore të aprovuar nga KKPK-ja. Vendimi individual i referohet Vendimit Grupor të KKPK-së dhe paragrafit të veçantë i cili thekson arsyet për vendimin sa i përket kërkesës.

Vendimet e KKPK-së gjenden të publikuara në ueb faqen e AKP-së.

4.6 Urdhrat dhe Mjetet Ligjore

Komisioni mund të aprovojë, refuzojë apo hedh poshtë kërkesën dhe është i kufizuar nga kriteret e vendosura në vendimet e veta, përveç nëse ekzistojnë arsye të cilat e detyrojnë të shmanget nga ato kritere. Ai mund të caktojë vetëm mjetin ligjor i cili i ofrohet me Legjislacionin në fuqi dhe nuk mund të caktojë shpenzime të cilat rrjedhin nga procedura në favor të apo kundër ndonjëres palë në procedurë.

KPPK-ja mund t'i referojë çështjet të cilat dalin në lidhje me kërkesën, e që nuk janë në juridiksionin e tij, apo pjesë të veçanta të kërkesave të tilla, nëse vendimmarrja mbi ato pjesë të ndara nuk ngritë çështjet e pronësisë apo të drejtat e shfrytëzimit të pronës siç parashihet në legjislacionin në fuqi, në gjykatën kompetente vendore apo gjykatën administrative.

KPPK-ja ka përcaktuar në jurisprudencën e vet që nuk ka kompetencë të japë kompensim në të holla. Në rastet kur paraqitësit e kërkesave kërkojnë gjithashtu edhe kompensim për dëmin material apo për shfrytëzim të paautorizuar të pronës së kërkuar, përveç konfirmimit të pronësisë, KPPK-ja ka hedhur poshtë këtë aspekt të kërkesës duke mbajtur qëndrimin se nuk ka kompetencë të aprovojë një ndihmë të tillë ligjore.

KAPITULLI 5

ZBATIMI

5.1 Hyrje

Sipas legjislacionit në fuqi, zbatimi efikas i vendimeve përfundimtare të Komisionit për kërkesat është arritur përmes masave që përfshijnë, por nuk janë të kufizuara, në vendosjen e pronës nën administrimin e AKP-së, dëbimin, konfiskimin dhe shkatërrimin e strukturave të paligjshme, ankandet dhe marrëveshjet për qiranë. Zbatimi i vendimeve të KKPK-së është punë e Sekretarisë Ekzekutive, e cila kryhet nga Njësi i Implementimit. Aktivitetet e zbatimit që përfshijnë dëbimin e uzurpuesve të paligjshëm i kryen Njësi i Dëbimeve të AKP-së.

5.2 Shpërndarja dhe Zbatimi i Vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës

Procedura e shpërndarjes së vendimeve të KKPK-së si shkalla e parë e procesit të zbatimit përfshin Qendrën e Thirrjeve të AKP-së, e cila i kontakton me telefon palët në kërkesë për t'i informuar së vendimi është lëshuar dhe mund të merret, si dhe cakton takimin me ta për t'iu dorëzuar vendimet në Zyrën e AKP-së apo në Zyrat Pronësore të UNHCR-së (ku është e mundur) sipas preferencës së paraqitësit të kërkesës. Pas dorëzimit të vendimit, ka një afat prej 30 ditësh për ankesë në Gjykatën Supreme përmes Sekretarisë Ekzekutive, i cili afat fillon ditën që dorëzohet vendimi. Përveç kësaj, ky takim ofron mundësi për t'i informuar paraqitësit e kërkesave me procesin e implementimit dhe për t'i njoftuar paraqitësit e suksesshëm të kërkesave nëse dhe si do të donin të zbatohej vendimi. Pas problemeve të notifikimit dhe ndërprerjes së lëshimit të vendimeve nga KKPK-ja, siç është cekur më lart, shpërndarja e vendimeve është ndërprerë dhe numri i përgjithshëm i vendimeve të shpërndara në fakt është zvogëluar, sepse vendimet e bazuara në notifikimin e gabueshëm janë shfuqizuar. Gjatë periudhës së raportimit, AKP-ja ka shpërndarë 14,845 vendime për paraqitësit e kërkesave duke përfshirë 51 kërkesa të hedhura poshtë nga Sekretaria Ekzekutive. 12,196 vendime u janë shpërndarë paraqitësve të kërkesave personalisht dhe paraqitësit e kërkesave janë njoftuar përmes listave të publikuara në Zyrat Rajonale për 2,643 vendime të cilat nuk i kanë marrë, dhe 6 vendime tjera janë shpërndarë përmes ueb faqes së AKP-së.

AKP-ja ka pranuar 7,987 kërkesa për vënien e pronës nën administrim, 633 kërkesa për ri-posedim dhe 609 kërkesa për mbyllje të rastit nga paraqitësit e suksesshëm të kërkesave. Janë përpunuar 5,921 kërkesa për administrim dhe janë dërguar në Njësinë për Administrimin e Pronave, 264 raste janë përpunuar për ri-posedim, 321 kërkesa janë dërguar për mbyllje me kërkesën e paraqitësit të kërkesës, 688 kërkesa janë hedhur poshtë/refuzuar dhe nuk është bërë asnjë ankesë për mbylljen e rastit, 369 kërkesa për tërheqje të kërkesave të paraqitura nga paraqitës të kërkesave dhe 414 kërkesa tjera janë dërguar për mbyllje për shkak të mosbashkëpunimit. Numri i përgjithshëm i vendimeve të KKPK-së gjatë periudhës së raportimit është 7,977.

5.3 Shpërndarja dhe Zbatimi i Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës për ankesat kundër vendimeve të KKPK-së

Sipas legjislacionit në fuqi ankesat kundër vendimeve të KKPK-së janë paraqitur në Gjykatën Supreme përmes Sekretarisë Ekzekutive e cila është gjithashtu përgjegjëse për shpërndarjen dhe zbatimin e aktgjykimeve. Procedurat dhe formati që përdoret për paraqitjen e ankesave është bërë në marrëveshje me Panelin e Ankesave të Gjykatës Supreme. Aktgjykimet e Gjykatës Supreme dërgohen në AKP dhe Sekretaria Ekzekutive iu shpërndan vendimet palëve. Shpërndarja e aktgjykimeve të Gjykatës Supreme dhe njoftimi për mbledhjen e taksave gjyqësore ndjek të njëjtën procedurë si njoftimi për vendimet e KKPK-së siç është përshkruar në pjesën 5.2 më lart. Aktgjykimet e Gjykatës janë të formës së prerë dhe të zbatueshme dhe nuk mund të kundërshtohen përmes mjeteve ligjore të zakonshme apo të jashtëzakonshme; dhe bëhen të ekzekutueshme pesëmbëdhjetë ditë pasi të bëhet njoftimi i palëve.

Gjatë periudhës raportuese AKP-ja ka pranuar 162 ankesa kundër vendimeve të KKPK-së. Prej tyre, 154 i kanë plotësuar kriteret e ankesës dhe si rezultat 166 (përfshirë disa ankesa të pranuar në vitin 2011) janë dërguar në Gjykatën Supreme. Gjykata Supreme ka vendosur 199 ankesa, 138 prej të cilave janë refuzuar kurse 61 janë aprovuar. Prej tyre 63 Aktgjykime të Gjykatës Supreme u janë dërguar paraqitësve fillestarë të kërkesave, 12 palëve përgjegjëse fillestare dhe 11 palëve të interesuara.

5.4 Zbatimi i vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore

AKP-ja ka gjithashtu mandat sipas legjislacionit të në fuqi të zbatojë kërkesat pronësore banesore të cilat kanë qenë në pritje më 4 mars 2006, dhe të menaxhojë dosjet e pronave të administruara nga DÇPB-ja. Për të ushtruar këtë aspekt të mandatit të saj, AKP-së i janë dhënë të drejtat, obligimet, përgjegjësitë dhe kompetencat e DÇPB-së.

Vendimi përfundimtar i KKPB-së në pritje të zbatimit gjendej në pjesën veriore të Mitrovicës. Kjo kërkesë ishte realizuar në muajin shtator 2012 dhe prandaj, të gjitha vendimet e KKPB-së tani janë zbatuar.

Përveç kësaj, ka pasur disa kërkesa të paraqitura në DÇPB dhe të vendosura nga KKPB-ja ku paraqitësit e suksesshëm të kërkesave nuk kanë kërkuar zbatimin e vendimeve në atë kohë, dhe DÇPB-ja i kishte mbyllur këto raste pa zbatimin fizik. Si pasojë, AKP-ja ka pranuar gjatë vitit 2012, gjithsej 20 kërkesa për ri-posedim të paraqitura nga paraqitësit e suksesshëm të kërkesave. Duke pasur parasysh se paraqitësit e kërkesave në të gjitha këto kërkesa kanë pasur të drejtë për dëbim sipas vendimit të KKPB-së, të gjitha këto kërkesa janë aprovuar. Në 17 raste prona u është kthyer në ri-posedim paraqitësve e kërkesave, kurse për 3 rastet e mbetura procedura është duke vazhduar dhe vendimi i KKPB-së do të zbatohet në kohën e duhur.

5.5 Zbatimi i Skemës së Kompensimit

AKP-ja, si pasardhëse e DÇPB-së, është përgjegjëse për ndarjen dhe administrimin e skemës së kompensimit që ka të bëjë me pronat banesore shoqërore ku KKPB-ja ka konstatuar se bartësit të parë të së drejtës pronësore për shkak të diskriminimit, nuk i është dhënë mundësia ta blejë pronën banesore në fjalë, dhe pastaj ajo i ishte ndarë një pale tjetër e cila pastaj e ka blerë atë.

Neni 19 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079 thotë se:

“Agjencia Kosovare e Pronës merr përsipër përgjegjësitë e Drejtoratit për Çështje Pronësore Banesore sipas nenit 4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/60 për kthimin e të drejtave të banimit për banesat shoqërore të humbura si rezultat i diskriminimit. Dispozitat e saj do t'i zbatojë në pajtim me kriteret dhe procedurat e miratuara nga Agjencia Kosovare e Pronës për llogaritjen e shumave nga neni 4 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/60”.

Bordi Mbikëqyrës i AKP-së ka miratuar kriteret dhe procedurat në mbledhjen e mbajtur më 13 korrik 2011 dhe është ndërmarrë puna pasuese në lidhje me përcaktimin e kostos së saktë të skemës dhe mënyrës se si të financohet skema. Përveç kësaj, Ministria e Financave ka krijuar një fond mirëbesimi për skemën. AKP-ja u ka dërguar një letër të gjithë donatorëve duke ofruar një propozim për financimin e skemës, megjithatë nuk ka pasur përgjigje pozitive dhe si e tillë çështja i është drejtuar Qeverisë së Kosovës për të kërkuar fonde të nevojshme për zbatimin e skemës. Janë mbajtur disa takime dhe konsultime të mëtejshme në mënyrë që çështja të shtyhet përpara.

5.6 Mbyllja e Kërkesave

Pas përfundimit të zbatimit të kërkesës, kërkesa duhet të mbyllet dhe këtë punë e kryen Njësi të Mbylljen e Kërkesave. Objektivat e fazës së mbylljes janë që të sigurohet se mekanizmi i AKP-së siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi dhe me Procedurat Operative Standarde në fuqi përputhet me të gjitha fazat e përpunimit të kërkesës deri në zbatimin e kërkesave të vendosura. Kjo është posaçërisht e rëndësishme kur ka të bëjë me afatet kohore dhe procesin e duhur si dhe kur gabimet e gjetura paraqiten si duhet.

Gjatë vitit 2012, janë mbyllur gjithsej 4,790 kërkesa, me:

- 99 kërkesa të mbyllura nga kategoria “mosbashkëpunim - paraqitësi i kërkesës është informuar për vendimin final”;
- 3,099 kërkesa të zbatuara përmes “administrimit”;
- 102 kërkesa të zbatuara përmes “ri-posedimit pa dëbim”;
- 41 kërkesa të mbyllura pasi janë “hedhur poshtë nga Sekretaria Ekzekutive”;
- 286 kërkesa “të mbyllura pa zbatim”;
- 111 kërkesa të zbatuara përmes “ri-posedimit me dëbim”;
- 5 kërkesa të mbyllura nga kategoria “mosbashkëpunim - paraqitësi i kërkesës nuk e ka marrë vendimin final”;
- 219 kërkesa të mbyllura pasi janë “hedhur poshtë nga KKPK”;
- 46 kërkesa të mbyllura pasi janë “refuzuar nga KKPK”, dhe
- 2 kërkesa të mbyllura pasi janë “hedhur poshtë nga KKPK dhe janë referuar në gjykatën vendore.”

173 kërkesa janë mbyllur meqë ishin “të tërhequra nga paraqitësit e kërkesave”, dhe

607 kërkesa të zbatuara me “kërkesa për administrim e mohuar”.

KAPITULLI 6

ADMINISTRIMI I PRONËS, SKEMA VULLNETARE E QIRASË DHE AKTIVITETET E DËBIMIT

6.1 Administrimi i Pronës Banesore

Me Rregulloret e UNMIK-ut 1999/23 dhe 2000/60 DÇPB-ja u autorizua që të vendosë pronat nën administrimin e saj të përkohshëm. Në mars të vitit 2006, AKP-ja, duke marrë përgjegjësinë për operacionet e DÇPB-së, mori përgjegjësinë për menaxhimin e pronave që tashmë ishin nën administrim të DÇPB-së, si dhe për vazhdimin e zbatimit të skemës.

Neni 23.1 i Shtojcës I të legjislacionit në fuqi e autorizon AKP-në të administrojë pronat në secilën nga këto rrethana:

- Me marrëveshje në mes të palëve për zgjidhjen e kërkesës së paraqitur në AKP;
- Me kërkesën e paraqitësit të kërkesës, pas vendimit përfundimtar i cili konfirmon të drejtën pronësore të paraqitësit të kërkesës;
- Nëse nuk është paraqitur kërkesë për administrim të pronës, pas zbatimit të vendimit të Komisionit dhe dëbimit të banuesit aktual, nëse bartësi i së drejtës pronësore dështon që pronën ta kthejë në ri-posedim pas njoftimit për ekzekutimin e dëbimit.

Punët dhe detyrat lidhur me Administrimin e Pronave kryhen nga Njësi i Administrimit të Pronave i AKP-së.

Gjatë periudhës së raportimit rreth 3,505 prona të reja janë marrë nën administrim të AKP-së, nga të cilat 3,385 ishin prona bujqësore, 7 ishin prona komerciale dhe 113 prona banesore. 1,170 kërkesa për administrim janë mohuar për shkak të disa përjashtimeve, siç janë pyjet, të cilat nuk mund të merren nën administrim. Gjatë kohës së raportimit kanë qenë 8,186 prona nën administrim të AKP-së, edhe pse në afro 200 raste bartësi i së drejtës pronësore/pronari ka paraqitur kërkesë për ndërprerjen e administrimit.

Gjatë periudhës së raportimit AKP-ja ka dorëzuar 32 prona, të cilat ishin marrë ex officio nën administrim. Kanë mbetur edhe 410 prona dhe AKP-ja vazhdon me strategjinë e zbatuar në prill të vitit 2009 për të identifikuar bartësit e së drejtës pronësore dhe për t'iu mundësuar atyre marrjen nën kontroll të pronave.

6.2 Skema e Qiradhënies Vullnetare

Neni 1.1(b) i Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 parasheh që Skema e Qiradhënies të zbatohet për pronat që janë nën administrim, ku parat e mbledhura nga qiraja për pronën nën administrim do të vireshin në një llogari të posaçme mirëbesimi për pronarin e ligjshëm. Një skemë e tillë e qirasë ishte propozuar gjatë kohës së funksionimit të DÇPB-së, por për shkak të natyrës së ndjeshme politike të kësaj çështjeje, AKP-ja mori aprovimin e nevojshëm politik tek në gusht të vitit 2006 dhe u bë e zbatueshme në tetor të vitit 2006.

Skema e Qiradhënies Vullnetare ofron burim të të ardhurave minimale nga pronat për bartësit e së drejtës pronësore/pronarët, të cilët përndryshe mund të vendosin t'i shesin pronat e tyre.

Me një vlerësim të favorshëm të kushteve dhe të përshtatshmërisë së pronës për ta vendosur në Skemë e Qiradhënies Vullnetare, dhe me pajtimin e bartësit të së drejtës pronësore/pronarët e pronave, AKP-ja do të provojë që të lëshojë me qira pronën përmes një marrëveshjeje më palën e tretë. Nëse lokalet nuk lëshohen me qira nuk do të ketë pagesë të qirasë, por nëse pala e tretë pajtohet që ta marrë me qira pronën, atëherë AKP-ja e mbledh qiranë në baza mujore për pronat banesore dhe ato komerciale, ndërsa për pronat bujqësore mbledh qiranë në baza vjetore dhe ia dorëzon atë bartësit të së drejtës pronësore, duke ndalë 5% të shumës për shpenzime administrative. Në rastet kur qiraja nuk paguhet, AKP-ja mund dhe do ta dëbojë banorin. AKP-ja merr depozitë për pronat banesore dhe komerciale nga qiramarrësi për të mbuluar ndonjë qira të papaguar, ose ndonjë dëmtim të pronës nëse qiramarrësi është përgjegjës për këtë dëmtim. Pjesa e mbetur e depozitës do t'i kthehet qiramarrësit pas përfundimit të marrëveshjes dhe pas inspektimit të pronës.

Në kohën e raportimit 958 qiramarrës kanë nënshkruar marrëveshjen e qirasë, prej të cilave 35 janë për prona bujqësore, 1 është për pronë komerciale dhe 922 për prona banesore.

6.3 Natyra dhe Numri i Pronave në Skemën Vullnetare të Qiradhënies

Gjatë periudhës së raportimit, 865 prona të reja janë përfshirë në skemën vullnetare të qirasë, prej të cilave 831 prona bujqësore, 1 pronë komerciale dhe 33 prona banesore. Deri në fund të periudhës së raportimit, gjithsej 3,119 prona janë përfshirë në Skemën Vullnetare të Qiradhënies. Nga numri i përgjithshëm i pronave nën administrimin e AKP-së, 391 prona janë identifikuar si të papërshtatshme për t'u përfshirë në skemë për shkak, të lokacionit të tyre, ose për shkak të kushteve të këqija.

Gjatë periudhës së raportimit nga Skema e Qiradhënies është mbledhur një shumë prej 612,579.11€, nga kjo shumë, 531,772.50€ u janë transferuar pronarëve të identifikuar; 48,828.59€ mbahen si depozitë për pronarët e paidentifikuar dhe 30,415.74€ mbahen si depozita të sigurisë. Shuma prej 20,504.27€ është rezervuar për shpenzime administrative të zbatimit të skemës.

Banori, i cili nuk pranon që të paguajë qiranë, ose ka ndaluar së paguari atë, ka 30 ditë afat për të lëshuar pronën. AKP-ja e zbaton dëbimin pasi të ketë kaluar afati prej 30 ditësh, nëse banori nuk e ka liruar pronën vullnetarisht. Pas lirimit të pronës ajo mund t'i lëshohet me qira ndonjë qiramarrësi tjetër. Kur prona nuk është e dëmtuar, qiramarrësit të dëbuar i kthehet depozita e tij/saj.

6.4 Aktivitetet e Dëbimit

Më 29 shtator 2011, u nënshkrua versioni i rishikuar i MiM me Policinë e Kosovës për të mbështetur AKP-në në rastet e dëbimeve. Ky version i rishikuar zyrtarizoi një procedurë të re të zbatuar nga AKP-ja, me qëllim që personeli rajonal i AKP-të të ndërmarr dëbimin fillestar pa mbështetjen e policisë. Dëbimi fillestar përfshin: njoftimin për vërejtjen e fundit, me të cilin njoftohen uzurpuesit se në rast të ri-posedimit ata duhet ta lirojnë pronën, apo në rast se nuk e paguajnë qiranë ata duhet të paguajnë shumën e qirasë të detyrueshme sipas kontratës së qirasë, ose ta lirojnë pronën brenda afatit të dhënë. Në datën kur skadon afati, personeli rajonal kthehet në pronë për të kryer dëbimin ose në rast se prona lirohet vullnetarisht, për të siguruar pronën. Në rast se uzurpuesi refuzon të lirojë pronën atëherë planifikohet dëbimi me mbështetjen e policisë. Pas planifikimit të dëbimeve, ato nuk mund të anulohen përveç në rrethana të jashtëzakonshme, dhe atë vetëm me miratimin e Drejtorit apo zv/Drejtorit Ekzekutiv të AKP-së.

Gjatë vitit 2012, Njësia e Dëbimit ka planifikuar 2,617 dëbime. Nga këto, 832 dëbime fizike janë ndërmarrë nga Njësia e Dëbimit me mbështetjen e Policisë së Kosovës, 161 ishin për ri-posedim, 416 për uzurpim të paligjshëm, 120 për mospagesë të qirasë dhe 135 për refuzim për të hyrë në marrëveshje të qirasë. Ndërsa, 1,785 dëbime janë anuluar për shkak të pagesës së borxhit të qirasë pas paralajmërimit përfundimtar të lëshuar si pjesë e dëbimit fillestar nga Zyrat Rajonale.

Numri i përgjithshëm i dëbimeve në pritje, deri në fund të dhjetorit 2012, ka arritur në 655 dhe është paraqitur më poshtë si vijon:

Mitrovicë(Pjesa Jugore): 136 dëbime në pritje - 6 për ri-posedim, 16 për uzurpim të paligjshëm, 63 për mospagesë të qirasë dhe 51 për refuzim për të hyrë në marrëveshje të qirasë.

Mitrovicë(Pjesa Veriore): 326 dëbime në pritje - 20 për ri-posedim, 5 për uzurpim të paligjshëm, 128 për mospagesë të qirasë dhe 173 për refuzim për të hyrë në marrëveshje me qira.

Pejë: 85 dëbime në pritje - 10 për ri-posedim, 17 për uzurpim të paligjshëm, dhe 58 për mospagesë të qirasë.

Prishtinë: 72 dëbime në pritje - 3 për ri-posedim, 9 për uzurpim të paligjshëm, dhe 60 për mospagesë të qirasë.

Prizren: 22 dëbime në pritje - 2 për ri-posedim, 1 për uzurpim të paligjshëm, 5 për shkak të mospagesës së qirasë dhe 6 për refuzim për të hyrë në marrëveshje me qira.

Gjilan: 13 dëbime në pritje - 5 për ri-posedim, 1 për uzurpim të paligjshëm, 1 për mospagesë të qirasë dhe 6 për refuzim për të hyrë në marrëveshje me qira.

Bazuar në totalitetin e dhënave më sipër, mund të shihet se Rajoni i Mitrovicës është rajoni i cili është më së paku në përputhje me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore. Mbështetja e të gjitha palëve, duke përfshirë publikun, është e nevojshme për të adresuar këtë çështje. AKP-ja ka adresuar këtë çështje edhe tek disa organizata ndërkombëtare, dhe si zgjidhje ideale për këtë çështje sipas pikëpamjeve të AKP-së, do të ishte që të gjithë personat të cilët në mënyrë të paligjshme kanë zënë një pronë, ta rregullojnë atë uzurpim duke paguar qiranë e kërkuar, pasi kjo do t'i sigurojë bartësit të së drejtës pronësore të ardhura në vend të posedimit të pronës së tij, gjithashtu duke siguruar banuesin se ata nuk do të dëbohen nga prona pa marrë në konsideratë kushtet e marrëveshjes së qirasë, si dhe t'i lejojë AKP-së të përqendrohet në ato raste ku

dëbimi është i pashmangshëm kur bartësi i së drejtës pronësore kërkon ri-posedimin e pronës.

6.5 Rastet e ri-uzurpimit serik

Siç mund të shihet më lart, AKP-ja kryen lloje të ndryshme të dëbimeve.

Në rastet kur paraqitësi i kërkesës ka kërkuar ri-posedim, AKP e ndërmerr dëbimin në kohën e caktuar me paraqitësin e suksesshëm të kërkesës dhe përveç kësaj kërkon që paraqitësi i kërkesës apo përfaqësuesi i paraqitësit të kërkesës të marrë pjesë në dëbim. Në rastet kur paraqitësi i kërkesës apo përfaqësuesi i paraqitësit të kërkesës nuk merr pjesë në dëbim, ata i kanë 3 ditë afat për ta informuar AKP-në me dëshmi përkatëse që prona është ri-uzurpuar. Në këto raste, AKP-ja e merr pronën nën administrim dhe e kryen një dëbim të dytë në kohën e caktuar me paraqitësin e suksesshëm të kërkesës në mënyrë që paraqitësi i kërkesës apo përfaqësuesi i tij/saj të marrë pjesë në dëbim. Në rast të dëbimit të dytë, AKP-ja e mbyll rastin dhe çdo ri-uzurpim i pronës duhet të paraqitet nga paraqitësi i kërkesës tek autoritetet lokale.

Në rastet kur prona është nën administrimin e AKP-së, e përfshirë apo jo në Skemën Vullnetare të Qirasë, AKP-ja kryen dëbimin kur prona është uzurpuar në mënyrë të paligjshme, kur uzurpuesit i është ofruar pakoja e qirasë por ai/ajo refuzon ta paguajë qiranë, dhe kur një person ndërpret pagesën e qirasë. Është vërejtur që në shumicën nga këto raste, i njëjti person/familje që dëbohet nga prona, e ri-uzurpon menjëherë atë. Në shumë raste numri i ri-uzurpimeve dhe dëbimeve ka kaluar numrin dhjetë për personin dhe pronën e njëjtë. Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme dhe thyerja e drynit zyrtar është vepër penale sipas Kodit Penal të Kosovës dhe AKP-ja i paraqet këto raste në gjykatë kur ato ndodhin si dhe ka kërkuar mbështetjen e EULEX-it që këto raste të shqyrtohen në Prokurori dhe në Gjykata. Megjithatë, kjo nuk ka qenë efektive sa është prituri dhe nuk e ka pasur efektin e parandalimit në masën që është kërkuar. Për të adresuar këtë, më 23 gusht 2012 është arritur një marrëveshje me Policinë e Kosovës dhe prokurorët, me qëllim të arrestimit të këtyre ri-uzurpuesve dhe të trajtimit të këtyre rasteve seriozisht nga gjykatat në përputhje me Kodin Penal të Kosovës. Shpresohet se arrestimi dhe ndalimi i këtyre kriminelëve do të prodhojë efektin e dëshiruar për të parandaluar rastet e ri-uzurpimeve serike, gjë që sjellë harxhimin e panevojshëm të burimeve të AKP-së dhe të Policisë së Kosovës duke kryer më shumë se një dëbim nga e njëjta pronë, të të njëjtit banues të paligjshëm.

Gjatë vitit 2012, 141 raste për ri-uzurpim janë iniciuar në prokuroritë përkatëse. Nga këto, 40 raste janë vendosur nga gjykatat komunale përkatëse dhe 101 raste janë në pritje në prokuroritë apo gjykatat komunale. Kjo sjell numrin e përgjithshëm të rasteve për ri-uzurpim të iniciuar në prokuroritë përkatëse në 326. Nga këto, 67 raste janë vendosur nga gjykatat komunale përkatëse, dhe 259 raste janë në pritje në prokuroritë apo gjykatat komunale.

Pas zbatimit të marrëveshjes së 23 gushtit 2012, AKP-ja ka kërkuar arrestimin e 54 personave për uzurpim të paligjshëm. Policia e Kosovës ka arrestuar 15 uzurpues të paligjshëm, 34 uzurpues të paligjshëm nuk ishin të pranishëm në ditën e dëbimit dhe në 5 raste AKP-ja ka tërhequr kërkesën për arrestim.

KAPITULLI 7

PERSONELI DHE AFTËSIMI PROFESIONAL

7.1 Burimet Njerëzore

Gjithë përgjegjësinë për personelin dhe për aftësimin profesional e mbajnë Burimet Njerëzore të AKP-së.

Pasqyra e punonjësve të AKP-së është si më poshtë:

Numri i përgjithshëm i pozitave në AKP është 280 si në pasqyrën në vijim:

1. Punonjësit në vijim janë siguruar nga donacionet në natyrë të ofruara nga autoriteti financies që është paraqitur në shtyllën e parë dhe si të tillë nuk paguhën nga mjetet buxhetore të AKP-së:

Autoriteti financies	Numri i Punonjësve Ndërkombëtarë	Numri i Punonjësve vendorë
ICO/EULEX	6	6
Qeveria Norvegjeze	2	

2. Punonjësit në vijim janë kontraktuar të punojnë për AKP-në dhe si të tillë paguhën nga mjetet buxhetore të AKP-së:

Autoriteti financies	Numri i Punonjësve Ndërkombëtarë	Numri i Punonjësve vendorë
Fondi i Donatorëve	8	186 (prej tyre 12 në Serbi, 1 në Mal të Zi dhe 3 pozita plotësisht të financuara nga donatorët)*
BKK		72

* 170 punonjës vendorë në Kosovë paguhën nga BKK

	Numri i Punonjësve Ndërkombëtarë	Numri i Punonjësve vendorë
Gjithsej	16	264

Në vazhdimësi, AKP-ja rekruton kandidatë për të zëvendësuar punonjësit ndërkombëtarë dhe ven-

dorë që po largohen, në ato pozita ku ka arsytim të mjaftueshëm nga udhëheqësit e drejtpërdrejtë për zëvendësimin e tyre.

Menaxhmenti i AKP-së është ekip i përzier prej ndër-kombëtarëve, që mbajnë 17 % të posteve udhëheqëse, dhe vendorëve që mbajnë 83 % të posteve udhëheqëse, duke udhëhequr njësitë të ndryshme të AKP-së në tërë Kosovën. Gjatë periudhës së raportimit AKP-ja ka punësuar rreth 258 punonjës profesionalë vendor dhe punonjës tjerë, duke përfshirë këtu: juristë, asistentë juridik, përkthyes, kontabilistë, ekspertë për kompjuter dhe TI, si dhe punonjës mbështetës administrativ. Ndryshimi në numrin e përgjithshëm të pozitave vendore është për shkak të dorëheqjeve dhe rekrutimeve të vazhdueshme.

AKP-ja ka staf plotësues prej 72 shërbyesve civilë, të cilët paguhën nga BKK, me ç'rast kushtet dhe kriteret e punësimit të tyre, si dhe pagesa për ta, rregullohen sipas Ligjit për Shërbimin Civil. Punonjësit vendorë të AKP-së në Kosovë pagën bazë e marrin nga Buxheti i Kosovës, e cila pagë plotësohet edhe me fonde shtesë të donatorëve për të siguruar kështu një nivel të ngjashëm të pagave të punonjësve që janë siguruar deri në fund të vitit 2008, dhe mu për këtë arsye punësimi dhe pagesa e tyre rregullohen, përveç me Ligjin për Shërbyesit Civilë, edhe me politikat e personelit të AKP-së. Për punonjësit vendorë, të punësuar në Zyrat Pronësore të UNHCR-së, punësimi i tyre rregullohet me politikat e personelit të UNHCR-së dhe për punonjësit vendorë në Mal të Zi është siguruar kontratë plotësisht e financiar nga donatorët dhe zbatohen politikat e personelit të AKP-së. Në pajtim me ligjet në fuqi që kanë të bëjnë me tatimet dhe pensionet, AKP-ja zbrit një shumë të caktuar nga paga bruto e punonjësve, të cilën e dërgon në Administratën Tatimore të Ministrisë së Financave të Kosovës dhe Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës siç është më e përshtatshme.

Punonjësit ndërkombëtarë janë sjellë në KPA përmes një marrëveshje me UNDP-në për t'i siguruar AKP-së pesë punonjës nga stafi ndërkombëtarë, kjo marrëveshje ka hyrë në fuqi në janar 2012 për një periudhë një vjeçare.

Përveç punonjësve ndërkombëtarë të lartpërmendur, AKP-së i janë dërguar tre punonjës vullnetarë të KB-ve përmes UNDP-së. ICO-ja ka dërguar Drejtorin Ekzekuti kurse EULEX-i ka dërguar dy Komisionerë Ndërkombëtarë; Udhëheqësin e Zyrës së KKKP-së, dy zyrtarë ligjorë ndërkombëtarë si dhe gjashtë punonjës vendorë të EULEX-it.

Në bazë të një marrëveshje të mëhershme me Këshillin Norvegjez për Refugjatë, më 10 tetor 2010, Qendra Norvegjeze për të Drejtat e Njeriut (NCHR) dhe AKP-ja kanë hyrë në një MiM, për t'u zbatuar përmes Bankës Norvegjeze të Burimeve për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut (NORDEM), e cila financohet nga qeveria norvegjeze. Përmes këtij Memorandumi dy të deleguarit që janë rekrutuar nga NORDEM kanë filluar punën në janar 2011 për t'u angazhuar në Njësitin për Përpunimin e Kërkesave (NJPK). NORDEM ra dakord në muajin nëntor 2011 për vazhdimin e dy pozitive deri në fund të vitit 2012 dhe u arrit një marrëveshje për vazhdim të mëtejshëm të pozitive të deleguarve deri në fund të vitit 2013.

Pas miratimit të Ligjit 03/L-079 të gjithë punonjësit vendorë të AKP-së përfshirë këtu edhe punonjësit e financuar nga BKK-ja, kanë mundësi të marrin pjesë në trajnime të cilat organizohen nga Instituti Kosovar i Administratës Publike. Disa punonjësve u është ofruar mundësia dhe e kanë shfrytëzuar atë mundësi për të rritur aftësitë e tyre profesionale duke ndjekur këto trajnime. Në muajin dhjetor 2012, 189 punonjësve iu ofruan trajnime të jashtme në 3 nivele të ndryshme: udhëheqëse, profesionale dhe administrative, të cilat u siguruan nga një strukturë e njohur e trajnimeve të jashtme.

Megjithatë AKP-ja përdor teknologji moderne gjithëpërfshirëse, duke kompjuterizuar përpunimin e kërkesave, prapëseprapë ajo varet shumë nga njohuritë njerëzore dhe në këtë aspekt punonjësit e AKP-së përfaqësojnë shtyllën e Agjencisë. Janë zhvilluar eksperitiza të rëndësishme në fushën e kthimit të pronave gjatë disa viteve duke filluar nga paraardhësi i AKP-së, DÇPB-ja, ku pjesa më e madhe e punonjësve janë transferuar në AKP, pas mbylljes së DÇPB-së, për të mbajtur aftësitë e tyre institucionale dhe profesionale. Është e rëndësishme që AKP-ja të ketë burime të vazhdueshme që të mbajë punonjësit me përvojë dhe profesionalizëm të rëndësishëm.

Transferimi i brendshëm i punonjësve nga ato njësi puna, e së cilave po i afrohet fundit të njësitit të tjera, ku kanë nevojë për punonjës do të vazhdojë gjatë vitit 2013. Në qoftë se numri i punonjësve që është në dispozicion për t'u transferuar është më i madh se sa është numri i nevojshëm atëherë punonjësit tepricë do të duhet të pushohen nga puna.

7.2 Menaxhmenti dhe Personeli

Sekretaria Ekzekutive e AKP-së udhëhiqet nga Drejtori dhe Zëvendës Drejtori të cilët mbështeten drejtpërsëdrejti nga punonjësit vendorë të Zyrës Ekzekutive. Njësitë kryesore operative të AKP-së, që kanë të bëjnë me përpunimin dhe zbatimin e kërkesave, janë: Zyrat Rajonale që menaxhohen nga Koordinatori Rajonal; Njësi i Informimit; Njësi i Verifikimit të Dokumenteve; Njësi i Menaxhimit të Dosjeve dhe të

Dhënave, Njësi për Përpunimin e Kërkesave; Zyra e KKKP-së; Njësi i Implementimit; Njësi i Administrimit të Pronave; dhe Njësi i Dëbimeve. Punët dhe përgjegjësitë e këtyre njësive janë përshkruar më lart në këtë raport. Megjithatë, ka njësita të tjera që edhe pse nuk janë drejtpërdrejt të përfshira në përpunimin dhe zbatimin e kërkesave, gjithashtu luajnë një rol përbërës dhe të rëndësishëm në AKP.

Njësi i Administratës në AKP ofron mbështetje logjistike, shërbime të transportit, menaxhim të ndërtesës, shërbime të sigurimit, menaxhim të aseteve, shërbime të furnizimit dhe arkivimit për ZQ-në e AKP-së dhe Zyrat Rajonale.

AKP-ja përdorë teknologji moderne gjithëpërfshirëse, prandaj edhe përpunimi i kërkesave është mjaft i kompjuterizuar. Njësi i TI-së është përgjegjës për të ofruar mbështetje të përgjithshme teknike dhe për të mbajtur të qëndrueshëm mjedisin elektronik të punës. Për të lehtësuar përpunimin e kërkesave, menaxhimi i të dhënave dhe zhvillimi i aplikacioneve bëhet në bashkëpunim me shfrytëzuesin e fundit, si dhe zhvillimi dhe azhurnimi i aplikacioneve bëhet përmes identifikimit dhe përdorimit të teknologjive të reja. Trajnimi i stafit për përdorimin e aplikacioneve dhe pajisjeve të softuerit gjithashtu bëhet nga Njësi i TI-së.

Departamenti i Auditimit të Brendshëm i AKP-së është përgjegjës për të ofruar menaxhim të lartë dhe për të siguruar që sistemet e menaxhimit dhe kontrollit që aplikohen në AKP të jenë adekuate dhe të veprojnë në mënyrë efektive. Auditimi i brendshëm bën vlerësim të pavarur dhe objektiv për aktivitetet e njësive që i nënshtrohen auditimit të brendshëm dhe për udhëheqësit e njësive siguron analiza, rekomandime këshilla dhe informata lidhur me aktivitetet e shqyrtuara. Këtu, përfshihet promovimi i kontrolleve efektive me çmim të arsyeshëm. Njësi i Auditimit të Brendshëm kryen një varg shërbimesh të auditimit, përfshirë këtu edhe auditimet financiare, auditimet e përputhshmërisë, auditimet operative, auditimet e teknologjisë informative, si dhe shërbimet këshilluese.

Njësi i Përkthimeve në AKP punon në bashkëpunim me asistentët e përkthimit të sjellë nga EULEX-i, të cilët janë të dedikuar për punën e KKKP-së, dhe ofron shërbimet e përkthimeve me shkrim dhe me gojë për AKP-në. Këtu përfshihen vendimet e KKKP-së, memorandume dhe korrespondenca të ndryshme, raporte dhe çdo përkthim tjetër që nevojitet brenda mandatit të AKP-së.

Departamenti i Prokurimit në AKP ndërmerr të gjitha aktivitetet e prokurimit që kërkohen nga AKP-ja sipas Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik dhe Rregullat e Prokurimit Publik në Kosovë. Gjatë vitit 2012, Zyra e Prokurimit ka kryer me sukses gjithsej 73 prokurime, si dhe ka bërë vazhdimin e 6 kontratave nga prokurimet e mëparshme.

FINANCIMI DHE BUXHETI

8.1 Financimi

Çështjet buxhetore dhe financiare të AKP-së janë përgjegjësi e Njësitit të Financave të AKP-së. Edhe pse AKP-ja ka mandat për të përmbushur një nga funksionet kryesore të sundimit të ligjit në Kosovë, megjithatë nga institucioni kërkohet të sigurojë pjesën më të madhe të nevojave financiare nga kontributet vullnetare të donatorëve, për ndryshim nga aktivitetet tjera qeveritare të cilat kanë nivelet e duhura të financimit qendror.

Projektligji i Buxhetit për vitin 2012 është miratuar nga Qeveria e Kosovës më 28 tetor 2011, dhe është dorëzuar për shqyrtim në Komisionin për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Kosovës. Më 22 nëntor 2011, AKP-ja ka adresuar çështjen e diferencës ndërmjet kërkesës buxhetore të AKP-së për vitin 2012 dhe projekt-buxhetit të propozuar në Komisionin për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Kosovës, me arsyetimin e duhur në mënyrë që të përpiqet dhe të sigurojë fondet e nevojshme për të mbuluar një mungesë në mallra dhe shërbime në shumën prej 160.072€ dhe shpenzimet kapitale në shumën prej 224.000€ që do të ndodhte në qoftë se do të miratohej projektligji i buxhetit pa ndryshime. Buxheti i Kosovës për vitin 2012 është miratuar me datën 20 dhjetor 2011 dhe AKP-së i janë ndarë 1.756.761€ ku përfshihej një shumë shtesë prej 74.000€ për shpenzime të veta kapitale. Një kërkesë për shpenzime kapitale për automjete është refuzuar dhe mungesa në mallra dhe shërbime gjithashtu nuk u mbulua.

Nëpërmjet procesit të rishikimit gjashtëmujor të buxhetit, AKP-ja ka kërkuar një shumë shtesë prej 68,125€ për buxhetin e vet operativ, kurse i është ndarë një shumë shtesë prej 50,000€.

Të hyrat vetanake (THV) të mbledhura gjatë 2012 në vlerë prej 25.938€ (shuma aktuale e mbledhur është arritur në 25,245.79€) nuk i janë ndarë AKP-së përmes Ligjit të Buxhetit për vitin 2012. Megjithatë, THV prej 16.694 € janë bartur nga viti 2011, prej të cilave janë shpenzuar 11.160 €.

Gjatë periudhës së raportimit, u pranuan kontributet nga këta donatorë:

Qeveria Zvicerane është duke mbështetur financiarisht AKP-në me 1.230.000€ për periudhën 2011-2013

përmes një marrëveshjeje kontributi të nënshkruar në qershor 2011 në mes të Qeverisë së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave në emër të AKP-së, dhe Qeverisë së Zvicrës e përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (ZZB). Një shumë fillestare prej 500,000€ është marrë në korrik 2011, dhe një kësht i dytë prej 500,000€ është marrë në maj 2012, pas miratimit të raportit të projektit dhe raportit të auditorit të jashtëm për vitin 2011. Në nëntor 2012 janë vënë në dispozicion fonde shtesë në vlerë prej 89,000€ dhe është bërë një rishikim i marrëveshjes së grantit për të adresuar këtë financim shtesë.

Përveç kësaj, Qeveria Zvicerane financon edhe një projekt me titull: “Mbështetje për AKP-në”, i cili është projektuar për këshillim të mëtejshëm strategjik dhe udhëzime për Bordin Mbikëqyrës dhe Sekretarinë Ekzekutive, në lidhje me fazat e vendosjes dhe zbatimit të mandatit të AKP-së dhe të ardhmen e saj pasi të kenë përfunduar këto aspekte të mandatit të saj.

Gjithashtu, Qeveria Zvicerane ka rënë dakord për një donacion shtesë për të siguruar që AKP-ja të përfundojë vendosjen e kërkesave deri kah mesi i vitit 2013. AKP-ja ka përgatitur një propozim për staf shtesë i cili ishte miratuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim (ZZB). Megjithatë, para zbatimit të projektit AKP-ja është njoftuar nga njëri prej donatorëve se fondet që ishin kërkuar në vlerën prej 188,226€ e cila ishte aprovuar në parim, nuk mund të përdoret meqë AKP-ja e kishte propozuar atë në projekt propozimin e saj. Fondi në vlerën prej 89.000€, e ndara për projektin për personel shtesë është transferuar në AKP, siç përshkruhet më lart që pjesërisht të mbulojë këto fonde të humbura të donatorëve.

Qeveria e Shteteve të Bashkuara ka mbështetur AKP me 696.038\$ për periudhën gusht 2010 deri gusht 2012 përmes një marrëveshjeje kontributi të nënshkruar në gusht 2010. Kësti i parë prej 350.000\$ është dedikuar për shpenzimet e vitit 2011, ndërsa pjesa tjetër është shfrytëzuar në vitin 2012.

Qeveria e Norvegjisë ka mbështetur AKP-në me një grant në shumën prej 3,421.702 NOK, ekuivalent me 440,685€, përt'upërdorurnëgjysmënaparëtëvitit2012.

Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar ka mbështetur financiarisht AKP-në me një shumë prej 70.650£ ekuiv-

alente me 84.286€ për tremujorin e parë të vitit 2012, e cila ishte marrë në shkurt të vitit 2012. Përveç kësaj, Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar ka mbështetur AKP-në me fonde në shumën prej 200.000£ ekuivalent me 244,800€ për periudhën deri në mars 2013. Një shumë shtesë prej 50,000£ ekuivalent me 61.785€ është dhënë në dhjetor të vitit 2012 për të mbuluar pjesërisht fondet e humbura të donatorëve, të përmendura më parë.

8.2 Zbatimi i Buxhetit

Bashkëngjitur, në Shtojcën C është Buxheti i AKP-së për vitin 2012, i cili është ndarë si në vijim:

Paga dhe Mëditje:	1,848,916
Mallra dhe Shërbime*:	1,023,300
Shërbime komunale:	96,510
Investime Kapitale:	74,000

Gjithsej: 3,042,726

(*pagat e gjithë stafit vendor jashtë Kosovës paguhen nga kjo kategori ekonomike)

Duke pasur parasysh nevojat e rishikuara të AKP-së dhe marrjen e fondeve shtesë të donatorëve gjatë periudhës së raportimit, bashkëngjitur në Shtojcë D gjendet buxheti i rishikuar i AKP-së për vitin 2012 KPA me alokimet e rishikuara:

Paga dhe Mëditje:	1,850,122
Mallra dhe Shërbime*:	1,403,248
Shërbime komunale:	133,601
Investime Kapitale:	69,986

Gjithsej: 3,456,957

(*pagat e gjithë stafit vendorë jashtë Kosovës paguhen nga kjo kategori ekonomike)

Bashkëngjitur, në Shtojcë E, është pasqyra e Buxhetit të AKP-së për vitin 2012 e cila pasqyron mënyrën se si është shpenzuar Buxheti. Si përmbledhje, shuma e përgjithshme e përvetësuar nga BKK për vitin 2012 ishte 1,806,761€, prej së cilës janë shpenzuar 1,746,044.86€. Shuma e mbetur prej 60,716.14€, e cila nuk ka mundur të shpenzohet brenda vitit 2012 për shkak të diferencës ndërmjet shumës së planifikuar kundrejt shumës aktuale të shpenzuar dhe faktit se disa nga proceset e prokurimit nuk kanë mundur të përfundojnë para mbylljes së vitit fiskal, kanë skaduar dhe fondet janë mbajtur nga Ministria e Financave.

Shuma e donacioneve ishte 1,806,761€, prej së cilës janë shpenzuar 1,630,728.67€. Një shumë prej 23,537.88€,

si pjesë e fondeve të donatorëve të pranuar në dhjetor 2012, ishte planifikuar të bartej në vitin 2013 dhe si e tillë kjo nuk është e përfshirë në totalitetin e mësipërme. Përveç kësaj, një shumë tjetër prej 19,467.38€ në kursime nga shuma e planifikuar kundrejt shumës aktuale të shpenzuar është bërë, si e tillë shuma totale e bartur në vitin 2013 ishte 43,005.26€.

Përqindja e shpenzimeve nga mjetet e ndara nga buxheti i BKK-së për buxhetin e AKP-së për vitin 2012 ishte 97%. Sa i përket fondeve të donatorëve përqindja e shpenzimeve ishte, po ashtu, 97%.

8.3 Vlerësimi i donatorëve

Pas Vlerësimit të Donatorëve të AKP-së, i cili është bërë në muajin tetor të vitit 2010, dhe mëpastaj zbatimi i rekomandimeve, kulmuan me përgatitjen e një projekt-dokumenti për të mbështetur AKP-në nga viti 2011 deri 2013.

Rezultatet e paraqitura në projekt-dokumentin fillestar janë:

Rezultati 1: Deri në dhjetor 2011 të kryhen të gjitha notifikimet e mbetura, publikimet dhe verifikimet e kërkesave të regjistruara.

Rezultati 2: Më së voni deri në gusht 2012 të përpunohen plotësisht të gjitha 30,662 kërkesat e mbetura dhe AKP-ja t'ia përcjellë KKPK-së për vendimmarrje (me mundësi vazhdimi deri më 31 dhjetor 2012)

Rezultati 3: Vendosija e të gjitha kërkesave të mbetura të kryhet nga KKPK deri në gusht 2012 (me mundësi vazhdimi deri më 31 dhjetor 2012)

Rezultati 4: Deri në gusht 2013 AKP-ja t'i shpërndajë dhe zbatojë me sukses të gjitha 41,102 vendimet e KKPK-së (me mundësi vazhdimi deri më 31 dhjetor 2013).

Rezultati 5: Pronat nën kujdesin e AKP-së të vazhdojnë të administrohen në mënyrë efikase deri në dhjetor 2013.

Rezultati 6: Deri në dhjetor 2013 të merret dhe të zbatohet vendimi lidhur me të ardhmen e AKP-së pas vitit 2013 si një institucion tërësisht vendor i financuar nga Buxheti i Qeverisë së Kosovës.

Zyra Zvicerane për Bashkëpunim (ZZB) ka financuar një projekt mbështetës të AKP-së duke shfrytëzuar konsulentët e njëjtë, të cilët kanë bërë vlerësimin

filleshtar, për t'i siguruar AKP-së mbështetje të mëtejshme dhe në mënyrë të veçantë Bordit Mbikëqyrës. Ky projekt ka filluar në muajin nëntor 2011 me një rishikim të gjendjes aktuale dhe të përparimit të bërë sa u përket objektivave të parashtruara dhe financimit, të domosdoshëm për të përfunduar vendosjen dhe zbatimin e kërkesave. Rezultati kryesor i këtij projekti në vazhdim ishte përditësimi i projekt dokumentit 2011 – 2013. Raporti është lëshuar në muajin janar 2012 dhe përfshin rekomandimet në lidhje me çështjet operative dhe strategjike. Sekretaria Ekzekutive dhe Bordi Mbikëqyrës kanë adresuar rekomandimet e bëra dhe konkluzionet janë raportuar dhe pranuar në mbledhjen e donatorëve të AKP-së, të mbajtur më 16 maj 2012. Vizita e dytë e konsulentëve është bërë ndërmjet 18 dhe 22 qershorit 2012. Raporti i dalë në përgjithësi ishte pozitiv, por megjithatë u theksua në veçanti se objektivat e përpunimit/vendosjes së lëndëve nuk ishin përmbushur sipas planit të punës dhe projekt-dokumentit, dhe se kërkesat e mbetura jokon-testuese po bëheshin më të ndërlikuara, ku përveç tyre kërkesat e shfuqizuara të mbetura do të duhej të ripërpunoheshin në tërësi. Për më tepër, domosdoshmëria e ndarjes së kërkesave me qëllim të përpunimit të tyre, i shtohet numrit të përgjithshëm të kërkesave që duhej të përpunoheshin. Me qëllim të adresimit të dy pikave të para me një shqyrtim që është ndërmarrë nga juristët dhe koordinatorët të cilët aktualisht janë të punësuar, bazuar në kompleksitetin në rritje të kërkesave, është përcaktuar se numri i koordinatorëve në ekipin e kërkesave të pakontestuar nuk është adekuat për të siguruar që kërkesat e përpunuara nga juristët të mund të përpunohen në kohë të arsyeshme. Në vazhdimësi të kësaj, është bërë një vlerësim i stafit shtesë të nevojshëm për të siguruar përfundimin e fazës së vendosjes deri kah mesi i vitit 2013 dhe i është paraqitur ZZB-së. Për shkak të vështirësive financiare, ky projekt i stafit shtesë u desh të pezullohej. Megjithatë është rënë dakord në Bordin Mbikëqyrës se nëse do të viheshin në dispozicion fonde shtesë, atëherë projekti për staf shtesë do të rishikohej. Sa i përket ndarjes së kërkesave, Sekretaria Ekzekutive ka diskutuar çështjen me Komisionin dhe tani mund të pritët një zvogëlim i numrit të kërkesave të ndara, edhe pse në raste të caktuara kërkesat ende do të duhet të ndahen.

Sa i përket rezultatit 1, AKP ka vendosur të shtyjë notifikimin final dhe publikimin e kërkesave derisa të sigurohet që të gjitha ato kërkesa që kanë nevojë të ndahen, të jenë ndarë. Kjo pritët të jetë mënyra me kosto më efektive e përfundimit të këtyre dy proceseve, meqë notifikimi në shtyp do të duhet të bëhet në të njëjtën ditë në të gjitha gazetatat e përditshme në Kosovë. Sa i përket procesit të verifikimit, kjo bëhet në vazhdimësi

paralelisht me procesin e notifikimit dhe publikimit, dhe aktualisht diku rreth 446 kërkesa mbeten për t'u verifikuar.

Sa u përket rezultateve 2 dhe 3, AKP-ja më herët ka njoftuar Bordin Mbikëqyrës dhe donatorët se përfundimet e tyre nuk do të arrihen deri në muajin gusht 2012. Përfundimi i këtyre planifikohet të bëhet deri në muajin dhjetor 2013. Sidoqoftë, meqë seanca e Komisionit në muajin dhjetor do të mbahet në fillim të muajit dhjetor, një numër i kërkesave nuk do të përpunohen dhe prandaj, Seanca e fundit e Komisionit do të duhet të mbahet në fillim të vitit 2014. Në këtë drejtim, Bordi Mbikëqyrës ka kërkuar që të bëhet një vlerësim i nevojave të AKP-së që të arrihet drejt përfundimit të fazës e vendosjes deri në qershor 2013. Ky vlerësim përfshinte staf shtesë dhe marrjen parasysh të pagesës për punën jashtë orarit për juristët në ekipin e përpunimit të kërkesave.

Sa i përket rezultatit 4, AKP është duke shënuar përparim në zbatim, dhe deri më tani 29,652 vendime u janë dërguar paraqitësve të kërkesave. Nga këto, 13,124 kërkesa për administrim, 1,515 kërkesa për ri-posedim dhe 1,129 kërkesa për mbyllje të lëndëve janë pranuar nga paraqitës të suksesshëm të kërkesave. Për të siguruar që paraqitësit e kërkesave të përgjigjen me kërkesat e tyre të zbatimit në kohën e duhur, gjë që nuk ishte bërë më herët, atyre iu është caktuar një afat prej gjashtë muajve që të bëjnë kërkesa për administrim. Në rastet kur ky afat nuk përmbushet nga paraqitësi i kërkesës, ata do të mund të kërkojnë vetëm që lëndët të mbyllën, ose të ri-posedojnë pronat e tyre. Paraqitësit e Kërkesave në rastet e mbyllura më herët si raste jobashkëpunuese, janë kontaktuar dhe iu është caktuar afat prej tre muajve për të paraqitur kërkesat e tyre.

Sa i përket rezultatit 5, administrimi i pronave dhe përfshirja e tyre në Skemën e Qiradhënies Vullnetare është duke vazhduar.

Sa i përket rezultatit 6, janë bërë zhvillime në këtë drejtim dhe ato do të raportohen në të ardhmen kur të zbatohen vendime më konkrete.

KAPITULLI 9

SYNIMET OPERATIVE DHE TREGUESIT E PERFORMANCËS

9.1 Plani i punës për vitin 2012

Plani i punës i AKP-së për vitin 2012 ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2012. dhe ofron synimet operative dhe treguesit e performancës në bazë të të cilëve vlerësohet Agjencia. Plani, gjithashtu lejon që komuniteti i donatorëve dhe organet tjera të interesuara të kuptojnë më mirë natyrën dhe fushëveprimin e punës së AKP-së dhe qëllimet që ajo i ka vënë për t'i arritur.

Synimet kryesore operative për vitin 2012 në lidhje me kërkesat janë dhënë më poshtë:

A1. Numri i kërkesave të kontestuara, të pakontestuara dhe të shfuqizuara për t'u paraqitur në KKPK në secilën prej seancave të tij ka qenë i përcaktuar në bazë të numrit të ditëve të punës në muaj, të rregulluar për të marrë në konsideratë të drejtat për pushim vjetor dhe festat zyrtare, shumëzuar me numrin e kërkesave që juristët në Njësitin e Përpunimit të Kërkesave (NJPK) mund të përpunojnë si dhe me numrin e juristëve që punojnë në njësi.

Numri i kërkesave të paraqitura në gjashtë seancat e 2012 janë si më poshtë:

Seanca e shkurtit - 2416 të shfuqizuara, 1192 të pakontestuara dhe 202 të kontestuara;

Seanca e prillit - 1900 të shfuqizuara, 947 të pakontestuara dhe 167 të kontestuara;

Seanca e qershorit - 1,900 të shfuqizuara, 1283 të pakontestuara dhe 178 të kontestuara;

Seanca e gushtit - 900 të shfuqizuara, 1794 të pakontestuara dhe 362 të kontestuara;

Seanca e tetorit - 1234 të pakontestuara dhe 297 të kontestuara;

Seanca e dhjetorit - 960 të pakontestuara dhe 238 të kontestuara.

A2. Të gjitha kërkesat e vendosura nga KKPK në vitin 2012 me anë të nxjerrjes së vendimeve grupore do të individualizohen për secilën palë në kërkesë brenda një muaji kur vendimi grupor miratohet nga Kryesuesi i KPPK-së.

A3. Zbatimi i vendimeve të individualizuara duke njoftuar paraqitësit e kërkesave/palët përgjegjëse do të fillojë nga qendra e thirrjes sa më shpejt që pranohen vendimet e individualizuara..

Synimet kryesore operative për vitin 2012 në lidhje me Pronat nën Administrim dhe Skemën e Qirasë janë dhënë më poshtë:

B1. Pas pranimit të kërkesës për zbatim nga një paraqitës i suksesshëm i kërkesës në rastet kur nuk është pranuar ankesë brenda afatit të caktuar. Zyra e zbatimit përpunojë dhe dërgojë kërkesën për zbatim tek njësitë përkatëse brenda një muaji prej pranimit të kërkesës.

B2. Do të ndërmerren aktivitete të rregullta për të promovuar Skemën e Qirasë pronësore për të përfshirë në të pronat bujqësore dhe komerciale, në mënyrë që të rritet numri i qiramarrësve të pronave me qira deri në 1500.

B3. Me pranimin e pëlqimit të nënshkruar për një pronë që duhet të përfshihet në Skemën Vullnetare të Qiradhënies Njësia e Administrimit të Pronës do të bëjë inspektimin e pronave brenda një muaji nga marrja e saj, në mënyrë që të përfshin sa më shumë prona të përshtatshme në skemën vullnetare të qiradhënies.

B4. Do të bëhet largimi nga administrimi i ndërtesave të papërfunduara të cilat janë marrë ex officio nën administrimin.

9.2 Performanca e arritur kundrejt Synimeve Operative të Planit të Punës për Kërkesat

9.2.1 Synimi operativ A1:- Performanca do të matet kundrejt numrit të kërkesave që janë paraqitur në secilën nga seancat e KKPK-së siç shtjellohet në raportet për Komisionin dhe Bordin Mbikëqyrës.

Numri i kërkesave të paraqitura në tri seancat e para të mbajtura në vitin 2012 paraqiten si më poshtë:

Seanca e shkurtit – 2,514 të shfuqizuara, 798 të pakontestuara dhe 207 të kontestuara;

Seanca e prillit – 1,800 të shfuqizuara, 941 të pakontestuara dhe 171 të kontestuara;

Seanca e qershorit – 803 të shfuqizuara, 677 të pakontestuara dhe 168 të kontestuara;

Numri i kërkesave të paraqitura jo në të gjitha rastet i përmbush synimet dhe kjo është për shkak të një kombinimi të faktorëve. Në muajin janar 2012 ekipi i kërke-

save të pakontestuaru u plotësua tërësisht t me staf, dhe para se të ishin në gjendje të prodhojnë ndonjë kërkesë ata kishin nevojë të trajnoheshin. Deri në kohën kur u mbajt seanca e muajit prill ata prodhonin kërkesa dhe njësitë gati ishte në gjendje të plotësonte synimet e caktuara. Ekipi i kërkesave të kontestuaru ka përmbushur synimet për dy seancat e para dhe ka përmbushur synimin edhe për seancën e tretë. Sidoqoftë, faktor tjetër i identifikuar, i cili ka zvogëluar numrin e kërkesave të paraqitura në seancën e muajit qershor në veçanti është se kërkesat po bëheshin më të ndërlikuara dhe si të tilla, juristët që përpunonin kërkesat më nuk ishin në gjendje të arrinin objektivat ditore të cilat fillimisht ishin caktuar në planin e punës. Përveç kësaj, numri i kërkesave të cilat kanë mundur të grupohen së bashku, janë zvogëluar në mënyrë virtuale në zero dhe si të tilla të gjitha kërkesat e mbetura kishin nevojë të përpunoheshin veç e veç. Më tutje rreth kësaj, kërkesat e mbetura të shfuqizuara janë shqyrtuar dhe është konstatuar se të gjitha ato kanë nevojë të ripërpunohen, dhe si të tilla nuk mund të ndiqen shpejt nëpërmjet procesit të vendosjes siç mendohej më herët. Kjo çështje ishte diskutuar shkurtimisht në mbledhjen e Bordit Mbikëqyrës të mbajtur në qershor dhe ishte shtjelluar më tutje nga konsulentët mbështetës, siç përmendet në pikën 8.3 më lart. Objektivat e arritshme dhe reale për kërkesat e kontestuaru dhe të pakontestuaru me kërkesat e shfuqizuara të cilat janë duke u llogaritur si të pakontestuaru, që kanë dalë nga shqyrtimi i tërë punës paraqitet si më poshtë:

Seanca e gushtit – 901 të pakontestuaru dhe 179 të kontestuaru

Seanca e tetorit – 544 të pakontestuaru dhe 111 të kontestuaru

Seanca e dhjetorit – 547 të pakontestuaru dhe 117 të kontestuaru

Në mbledhjen e Bordit Mbikëqyrës të mbajtur në muajin qershor ishte rënë dakord që objektivat të rishikoheshin në bazë të rezultateve të raportit të konsulentëve, i cili ishte bërë në korrik 2012. Mbledhja pasuese e Bordit Mbikëqyrës është mbajtur në muajin tetor 2012, kohë në të cilën ishte konstatuar se ishte shumë vonë për të lëshuar përsëri planin e punës me objektivat e ndryshuara edhe pse objektivat e rishikuara do të përdoreheshin për qëllime raportuese.

Numri i kërkesave të paraqitura në tri seancat e fundit të vitit 2012 ishte:

Seanca e gushtit (mbajtur në shtator) – 1,631 të pakontestuaru dhe 222 të kontestuaru

Seanca e tetorit – 814 të pakontestuaru dhe 153 të kontestuaru

Seanca e dhjetorit – 672 të pakontestuaru dhe 135 të kontestuaru

ku të gjitha i kanë përmbushur objektivat e rishikuara, por siç mund të shihet, do të kishin qenë mjaft të shkurtra nga objektivat fillestare nëse këto nuk do të ndryshoheshin. Po ashtu, është me rëndësi të theksohet se cilësia e kërkesave të referuara në KKKPK ka mbetur e lartë dhe kjo do të duhet të mbahet edhe në të ardhmen edhe në qoftë se duhet shpenzuar shifrat. Nëse cilësia bie, atëherë kërkesat mund të kthehen prapa për ripërpunim, gjë e cila do ta dyfishonte punën, përpjekjen dhe kohën që do të shpenzohej për secilën kërkesë.

9.2.2 Synimi operativ A2:- *Performanca do të matet kundrejt numrit të kërkesave që individualizohen brenda një muaji nga miratimi i vendimit grupor, si përqindje e numrit të kërkesave të cilat përfshihen në secilin vendim grupor, siç shtjellohet në raportet për Komisionin dhe Bordin Mbikëqyrës.*

Ky synim operativ është duke u përmbushur, megjithatë, Zyra e KKKPK-së, e cila përbëhet kryesisht nga stafi i EULEX-it me mbështetje nga stafi i AKP-së, e ka gjithnjë e më të vështirë për të përballuar punën, nga Sekretaria Ekzekutive tek Komisioni. Edhe pse burime shtesë janë ofruar nga EULEX-i, jo të gjitha pozitat në dispozicion janë plotësuar, e ku përfshihet edhe një pozitë për një ndërkombëtar. Mund të pritët, që pasi të jenë siguruar këto burime shtesë, mund të mundësohet që vendimet grupore të merren më shpejt sesa që janë marrë më herët.

9.2.3 Synimi operativ A3:- *Zbatimi i vendimeve të individualizuara përmes njoftimit të paraqitësit të kërkesës/palës përgjegjëse do të fillojë nga qendra e thirrjeve sapo të merren vendimet e individualizuara.*

Ky synim operativ është duke u përmbushur, përveç në ato raste kur hollësitë kontaktuese të paraqitësve të kërkesave/palëve përgjegjëse shihen se janë jo të sakta. Në këto raste kërkohen më shumë informacione nga zyrat rajonale të AKP-së apo nga zyrat jashtë Kosove në përpjekje për të kontaktuar paraqitësin e kërkesës apo palën përgjegjëse në mënyrë që të bëhet dërgimi i vendimit.

9.3 Progresi i arritur kundrejt Synimeve Operative të Planit të Punës për Pronat nën Administrim

9.3.1 Synimi operativ B1:- Performanca do të matet kundrejt numrit të kërkesave të përpunuara dhe të dërguara njësisë përkatëse brenda një muaji nga pranimi i tyre kundrejt atyre që marrin kohë më shumë se një muaj për t'u përpunuar, siç shtjellohet në raportet për Komisionin dhe Bordin Mbikëqyrës.

Ky synim operativ është duke u përmbushur në lidhje me kërkesat për riposeditim dhe mbyllje të lëndëve. Sidoqoftë, në lidhje me kërkesat për administrim, synimi nuk është duke u përmbushur për shkak të numrit të madh të kërkesave të cilat janë duke u pranuar kryesisht për shkak të numrit në rritje të vendimeve të dorëzuara dhe zbatimit të procedurës për të adresuar "rastet e mosbashkëpunimit".

9.3.2 Synimi operativ B2:- Performanca do të matet me diferencën nga numri i synuar prej 1,500 pronave me qira kundrejt numrit aktual të pronave me qira siç shtjellohet në raportet për Komisionin dhe Bordin Mbikëqyrës.

Gjatë vitit Njësi për Administrimin e Pronës arriti të rris numrin e përgjithshëm të pronave të lëshuara me qira në 1,261. Megjithatë, për shkak të ndërprerjes së administrimit të 303 pronave shumë prej të cilave ishin përfshinë në Skemën e Qiradhënies Vullnetare numri i pronave të lëshuara me qira ka rënë. Numri i pronave nën administrim në janar 2012 ishte 4,881 dhe prej tyre 981 ishin lëshuar me qira që përbëjnë 20.09%, në fund të vitit 2012, 958 prona prej numrit të përgjithshëm prej 8,186 ishin lëshuar me qira, që përbëjnë 11.7%.

OSBE ka mbështetur KPA-në në nxjerrjen e një broshure, e cila ka ofruar informacione specifike në lidhje me dhënien e tokës bujqësore me qira. Shpresohet që kjo fletushkë së bashku me fushata tjera do të rrisnin qiradhënien në veçanti të tokës bujqësore, megjithatë kjo nuk e ka arritur efektin e dëshiruar. Në mënyrë që të përforcojë dhënien me qira të tokës bujqësore, AKP-ja ka blerë një makinë për korrjen e kulturave bujqësore dhe pritjet që humbja e mundshme e një kulture të kultivuar në mënyrë të paligjshme në tokën bujqësore, të përfshirë në Skemën Vullnetare të Qiradhënies, mund të bindë uzurpuesit e paligjshëm për të legalizuar shfrytëzimin e pronës. Deri më sot janë dhënë me qira 35 prona bujqësore.

9.3.3 Synimi operativ B3:- Performanca do të matet me numrin e pronave të përfshira në Skemën Vullnetare të Qiradhënies brenda një muaji nga data e marrjes së një pëlqimi të nënshkruar, siç shtjellohet në raportet për Komisionin dhe Bordin Mbikëqyrës.

Ky synim operativ po bëhet gjithnjë e më i vështirë për t'u përmbushur për shkak të numrit të kërkesave të cilat AKP i pranon. Formularët e miratimit janë marrë për 3,119 prona dhe 2,537 prej tyre janë përfshirë, ndërsa 391 janë refuzuar për shkak se pronat nuk kanë qenë të përshtatshme për përfshirje në skemën e qiradhënies.

9.3.4 Synimi operativ B4: Performanca do të matet kundrejt numrit të ndërtesave të cilat kthehen në përgjegjësi të autoriteteve përkatëse, siç shtjellohet në raportet për Komisionin dhe Bordin Mbikëqyrës.

Gjatë vitit 2012 në shtyp janë publikuar shpalljet në lidhje me dy ndërtesa specifike në mënyrë që të sigurohen të dhëna dhe dokumentacion mbështetës për të qenë në gjendje të përcaktohet se kush do të ishte autoriteti përkatës për lëndët. AKP ka marrë disa përgjigje por nuk ka mundur të sigurohet dokumentacion mbështetës dhe prandaj është konstatuar se këto prona kanë ardhur nga Projekti YU, dhe si të tilla do të duhet të mbesin nën administrim deri sa të miratohet legjislacioni i ri për të përcaktuar destinacionin e pronave. Kjo i lë 148 prona të përfshira në ndërtesën e papërfunduar që ka mbetur për t'u dorëzuar. AKP-ja vazhdon të diskutojë këto prona me Agjencinë Kosovare të Privatizimit në lidhje me këtë objektiv, meqë shumica e ndërtesave në fjalë duket se janë të lidhura me Ndërmarrjet Shoqërore.

KAPITULLI 10

VEPRIMTARITË INFORMATIVE DHE SHPËRNDARJA E INFORMATAVE PËR PUBLIKUN

10.1 Transparenca dhe Informimi

Gjatë periudhës së raportimit AKP-ja ndërmori një sërë iniciativash për të qenë më afër palëve në kërkesa, OJQ-ve, organizatave vendore dhe atyre ndërkombëtare, si dhe publikut të gjerë.

AKP-ja, gjithashtu vazhdon t'i ketë shërbimet e veta; Qendrën e Thirrjeve si dhe linjën telefonike dhe e-mailin (mailbox@kpaonline.org), të dedikuar për informata në mënyrë që palët të mund të informohen shpejt për statusin aktual të kërkesave të tyre, dhe të marrin informacione për procesin dhe procedurat që zhvillohen në AKP. Gjatë periudhës së raportimit 22,100 kopje të një fletëpalosjeve informuese për qiradhënien e pronave bujqësore janë prodhuar dhe shpërndarë duke ju falënderuar mbështetjes së misionit të OSBE-së në Kosovë.

Agjencia, gjithashtu vazhdon të ketë ueb-faqen (www.kpaonline.org) për kërkesat e AKP-së në mënyrë që të ofrojë një numër të madh të informacioneve dhe statistikave në lidhje me aktivitetet e saj, gjegjësisht për pranimin e kërkesave, vendimmarrjen për kërkesat nga ana e Komisionit, shpërndarjen dhe zbatimin e vendimeve të Komisionit, menaxhimin e dosjeve të pronave nën administrim dhe Skemën Vullnetare të Qiradhënies.

Gjatë vitit, AKP-ja ka vazhduar të jetë e pranishme në media. Përfaqësuesit nga AKP-ja morën pjesë në intervista në gazeta, radio dhe televizion, si dhe në konferenca për shtyp në lidhje me çështjet pronësore. Gjithashtu, AKP-ja rregullisht u ofron medieve informata dhe statistika të përditësuara për aktivitetet dhe politikën e saj, përmes Njësitit të Informimit.

10.2 Bashkëpunimi në mes Agjencie

Në përpjekje për t'iu ofruar informacione institucionale vendore dhe atyre ndërkombëtare, AKP-ja është takuar rregullisht me akterët tjerë në fushën e të drejtave pronësore, me qëllim të ngritjes së vetëdijes për punën e saj dhe rëndësinë e saj në ndërtimin e paqes, zhvillimin ekonomik dhe sundimin e ligjit. Këtu përfshihen, në mes tjerash, edhe UNHCR-ja; OSBE-ja dhe OJQ-të e ndryshme. AKP-ja ka zhvilluar takime, gjithashtu edhe me zyrtarë e Kuvendit dhe të Qeverisë së Kosovës. Përveç kësaj, zyrtarët e AKP-së rregullisht morën pjesë në takime, punëtori dhe seminare brenda dhe jashtë Kosovës, të organizuara nga organizatat dhe OJQ-të e përfshira në çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat pronësore dhe me procesin e kthimit.

KAPITULLI 11

PËRMBLEDHJE E GJENDJES SË KËRKESAVE DHE ADMINISTRIMIT TË PRONËS DERI MË 31 DHJETOR 2012

Numri i kërkesave të pranuar është përafërsisht 42,347 kërkesa, ky numër do të rritet me krijimin e kërkesave të reja për ngastra të cilat nuk janë të ngjitura me njëra-tjetrën, për kërkesat për tokën, ku duhet dhënë rekomandim tjetër në raport të përpunimit, dhe kur merret parasysh edhe numri i kërkesave të referuara nga gjykatat komunale.

Gjithsej 42,063 kërkesa janë notifikuar fizikisht dhe 42,246 kërkesa janë publikuar. Më 28 dhjetor 2010 AKP-ja ka nxjerrë numrin e fundit të Gazetës së Njoftimit, e cila është kombinuar, po ashtu, me numrin e fundit të Gazetës së Publikimit. Në të ardhmen, notifikimi i çdo kërkesë që duhet të notifikohet, e që nuk mund të notifikohet fizikisht, si dhe publikimi i kërkesave, do të bëhet përmes medieve të shtypura dhe njoftimeve publike.

Janë verifikuar dokumentet për 42,369 kërkesa, nga këto raporti i verifikimit është përgatitur për 41,456 kërkesa. Janë verifikuar dokumentet e paraqitura për 257 kërkesa, por të cilat u konsideruan të pamjaftueshme për të mbështetur kërkesën, në këto raste janë kontaktuar paraqitësit e kërkesave dhe nga ata është kërkuar që të paraqesin dokumente shtesë për të mbështetur kërkesat e tyre.

Prej numrit të përgjithshëm të kërkesave intervistat si përgjigje janë mbajtur për 2,244 kërkesa, ndërsa pala përgjegjëse ka kërkuar të drejtë ligjore në 2,850 kërkesa. Në intervistat e mbajtura si përgjigje në kërkesa, në 41 kërkesa pala e mundshme përgjegjëse nuk ka kërkuar të drejtë ligjore (por mund të ketë kërkuar leje për shfrytëzimin e pronën).

Janë pranuar 456 ankesa kundër vendimeve të KKKP-së. Nga këto 425 i kanë përmbushur kriteret e apelimit dhe rrjedhimisht 380 janë përcjellë në Gjykatën Supreme. 31 ankesa tjera janë identifikuar si kërkesa për korrigjimin e gabimeve tekstuale në vendime dhe dy prej tyre janë korrigjuar nga Zyra e KKKP-së. 39 ankesa kundër kërkesave të hedhura poshtë nga Sekretaria Ekzekutive janë pranuar nga Zyra e KKKP-së dhe janë kthyer në Sekretarinë Ekzekutive për përpunim. Gjykata Supreme ka vendosur për 279 ankesa, 209 prej të cilave janë refuzuar dhe 70 janë miratuar.

Numri i kërkesave të vendosura deri në dhjetor të vitit 2012, duke e përfshirë edhe seancën e dhjetorit, është 36,012. Megjithatë, Komisioni ka shfuqizuar 18,441 kërkesa duke u bazuar kryesisht në notifikim të gabuar (18,326) dhe për arsye të tjera teknike (115). 17,257 kërkesa që janë shfuqizuar tashmë janë ri-vendosur dhe kështu numri i kërkesave të vlefshme që janë vendosur është 34,828. Komisioni ka vendosur gjithsej 1,738 kërkesa kontestuese prej gjithsej 2,850 kërkesave kontestuese.

Paraqitësit e kërkesave janë njoftuar për 30,408 vendime, duke përfshirë 268 kërkesa të hedhura poshtë nga Sekretaria Ekzekutive. 26,173 vendime u janë shpërndarë paraqitësve të kërkesave personalisht dhe paraqitësit e kërkesave janë njoftuar përmes listave të publikuara në Zyrat Rajonale për 4,198 vendime të cilat nuk i kanë marrë, 37 vendime tjera janë shpërndarë përmes ueb faqes së AKP-së. Sekretaria Ekzekutive ka pranuar 13,334 kërkesa për vënien e pronës nën administrim, 1,533 kërkesa për ri-posedim dhe 1,147 kërkesa për mbyllje të rastit nga paraqitësit e suksesshëm të kërkesave. 9,057 kërkesa për administrim janë përpunuar dhe dërguar në Njësitin për Administrimin e Pronës, 1,020 raste janë përpunuar për ri-posedim, 790 kërkesa janë dërguar për mbyllje me kërkesën e paraqitësit të kërkesës. 947 kërkesa janë hedhur poshtë/refuzuar nga KKKP-ja ku nuk është marrë asnjë ankesë, 402 kërkesa për tërheqje të kërkesave të paraqitura nga paraqitësit e kërkesave dhe 3,043 kërkesa për shkak të mosbashkëpunimit nga paraqitësit e kërkesave janë dërguar për mbyllje. Numri i përgjithshëm i vendimeve të KKKP-së që janë zbatuar aktualisht është 15,284.

Aktualisht 8,186 prona të braktisura janë nën administrimin e AKP-së. 2,174 janë vënë nën administrim me kërkesën e paraqitësve të suksesshëm të kërkesave paraqitur KKKP-së; 410 janë vënë *ex officio* nën administrim me intervenimin të AKP-së dhe paraardhësit të saj, DCPB-së; dhe 5,602 janë vënë nën administrim me kërkesën e paraqitësit të suksesshëm të kërkesës të shpallur nga KKKP-ja. Në 32 raste, bartësi i së drejtës pronësore ka paraqitur kërkesë për ndërprerjen e administrimit në kohën e raportimit.

Gjithsej 3,732,515.50€ janë mbledhur në bazë të Skemës Vullnetare të qiradhënies; 2,859,852.30€ u janë transferuar pronarëve të identifikuar; 192,423.41€ janë mbajtur në depozitë për pronarët e paidentifikuar dhe 128,858.27€ po mbahen si depozita të sigurisë. Shuma prej 131,691.92€ mbahen si shpenzime administrative që rrjedhin nga operimi i skemës.

Deri më tani gjithsej 9,984 kërkesa janë mbyllur, me:

- 2,005 kërkesa të mbyllura nga kategoria “mosbashkëpunim - paraqitësi i kërkesës është informuar për vendimin”,
- 4,748 kërkesa të zbatuara përmes administrimit,
- 583 kërkesa të zbatuara përmes ri-posedimit pa dëbim,
- 700 kërkesa të mbyllura pa zbatim,
- 189 kërkesa të mbyllura pasi janë “hedhur poshtë nga Sekretaria Ekzekutive”,
- 260 kërkesa nga kategoria “mosbashkëpunim - paraqitësi i kërkesës nuk e ka marrë vendimin përfundimtar”,
- 196 kërkesa të zbatuara përmes “ri-posedimit me dëbim”,
- 14 kërkesa të mbyllura pasi janë “refuzuar nga KKPK”,
- 190 kërkesa të mbyllura pasi janë “tërhequr nga paraqitësi i kërkesës”,
- 421 kërkesa nga kategoria “ kërkesa e hedhur poshtë nga KKPK-ja”,
- 67 kërkesa nga kategoria “kërkesa e refuzuar nga KKPK-ja”,
- 4 kërkesa nga kategoria “kërkesa e hedhur poshtë nga KKPK-ja- referuar në gjykatën vendore”.
- 607 kërkesa të zbatuara me “kërkesa për administrim e mohuar”.

NGJARJET KRYESORE GJATË VITIT 2012

Qeveria e Norvegjisë i ka ndarë AKP-së një grant në shumën prej 3,421,702 NOK që është ekuivalent me 440,685€ për t'i shfrytëzuar në vitin 2012.

Qeveria e Shteteve të Bashkuara ka liruar këstin e dytë të marrëveshjes së kontributit 2010-2012 në shumën prej 346,038€.

AKP-së i është dhënë një shumë prej 1,756,761€ nëpërmjet Ligjit për Buxhetin e Kosovës, për vitin 2012.

Në shkurt u mbajt seanca e njëzet e shtatë e KKKP-së ku u vendos për 925 kërkesa të reja dhe për 2,499 kërkesa të shfuqizuara më parë.

Në muajin shkurt, Qeveria Britanike i siguroi AKP-së një grant në shumën prej 70,650£ që është ekuivalent me 84,286€.

Në shkurt PCN riemëroi z. Veijo Heiskanen si Kryetar të KKKP-së si dhe z. Norbert Wühler si anëtar ndërkombëtar të KKKP-së.

Në muajin mars, PCN-ja riemëroi z. Scott Bowen Drejtor të Sekretarisë Ekzekutive.

Në muajin mars u lëshua Raporti Vjetor i Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2011.

Në muajin prill u mbajt seanca e njëzetetë e KKKP-së ku u vendos për 600 kërkesa të reja dhe 1,792 kërkesa të shfuqizuara më herët.

Në muajin maj u pranua një shumë prej 500,000€ që përfaqëson këstin e dytë të kontributit zviceran për vitet 2011-2013.

Në muajin maj, Kuvendi i Kosovës riemëroi z. Adem Vokshin anëtar të KKKP-së, riemëroi z. Ujup Krasniqin dhe emëroi z. Ismajl Osdautajn anëtarë të Bordit Mbikëqyrës.

Në muajin qershor, Qeveria Britanike i siguroi AKP-së një grant në shumën prej 200,000£ që është ekuivalente me 244,800€ për periudhën deri në mars të vitit 2013.

Në qershor u mbajt seanca e njëzetë e KKKP-së ku u vendos për 1,022 kërkesa të reja dhe për 802 kërkesa të shfuqizuara më parë.

Në qershor PCN-ja vazhdoi emërimet e z. Scott Bowen si Drejtor i Sekretarisë Ekzekutive, z. Veijo Heiskanen

si Kryetar i KKKP-së si dhe z. Norbert Wühlersi anëtar ndërkombëtar i KKKP-së. .

Në muajin korrik AKP-së iu nda një shumë shtesë prej 50,000€ nëpërmjet ndryshimit të Ligjit për Buxhetin e Kosovës për vitin 2012.

Në muajin gusht, PCN-ja emëroi znj. Andrea Tomaszewicz si kryetare dhe anëtare ndërkombëtare të Bordit Mbikëqyrës; emëroi z. Ian Cliff si anëtar ndërkombëtar të Bordit Mbikëqyrës dhe riemëroi z. Markus Beachler si anëtar ndërkombëtar të Bordit Mbikëqyrës.

Në shtator, Grupi Drejtues Ndërkombëtar ra dakord për përfundimin e Pavarësisë së Mbikëqyrur të Kosovës. Pas kësaj, siç ishte rënë dakord nga Kuvendi i Kosovës më 7 shtator 2012, hynë në fuqi ndryshimet kushtetuese. Përveç kësaj, në fuqi hyri edhe Ligji 04/L-115 "Mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve në lidhje me Përfundimin e Mbikëqyrjes Ndërkombëtare të Pavarësisë së Kosovës", i cili më herët ishte shpallur me dekret të Presidentit të Kosovës më 4 shtator 2012. Ligji 04/L-115 ndryshoi gjithsej 21 ligje, përfshirë edhe Ligjin 03/L-079 "mbi Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për Zgjidhjen e Kërkesave të Ndërlidhura me Pronën e Paluajtshme Private, Përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale".

Në shtator u mbajt seanca e tridhjetë e KKKP-së ku u vendos për 1,161 kërkesa të reja dhe për 661 kërkesa të shfuqizuara me parë.

Në tetor u mbajt seanca e tridhjetenjë e KKKP-së ku u vendos për 734 kërkesa të reja dhe për 228 kërkesa të shfuqizuara me parë.


Në nëntor u vazhdua Memorandumi i Mirëkuptimit me UNHCR-në edhe për një periudhë një vjeçare.

Në dhjetor u mbajt seanca e tridhjetedytë e KKKP-së ku u vendos për 617 kërkesa të reja dhe për 181 kërkesa të shfuqizuara me parë.

Në dhjetor u pranua një shumë prej 89,000€ si fond shtesë i kontributit zviceran për vitet 2011-2013.

Në dhjetor u pranua një shumë prej 50,000£ ekuivalente me 61,785€ si fond shtesë i grantit të Qeverisë Britanike.

DIAGRAMI I PROCEDIMIT TË KËRKESËS NË KPA



Gjithsej të vendosura			36,012		
Gjithsej të shfuqizuara			18,441		
Gjithsej të vendosura më pak vendime të shfuqizuara			17,571		
Plus vendime të rivendosura			17,257		
		Totali i përgjithshëm	34,828		

2007-2012	Seanca e KKPK-së	Nr. Kërkesave të referuara Komisionit	Kërkesa të vendosura	Kërkesa të kthyer në Sekretari	
				Numrat	% e referuar
Qershor-07	Seanca 1	955	498	457	48
Gusht-07	Seanca 2	1179	487	692	59
Tetor-07	Seanca 3	544	528	16	2.9
Dhjetor-07	Seanca 4	1863	1833	30	1.6
Shkurt-08	Seanca 5	2415	2403	12	0.5
Prill-08	Seanca 6	2617	2586	31	1.18
Qershor-08	Seanca 7	2880	2850	30	0.87
Gusht-08	Seanca 8	3050	2920	130	4.26
Tetor-08	Seanca 9	2622	2594	28	1.07
Dhjetor-08	Seanca 10	2190	2140	50	2.34
Prill-09	Seanca 11	512	504	8	1.5
Qershor-09	Seanca 12	2520	2474	46	1
Gusht-09	Seanca 13	1094	859	235	21.4
Dhjetor-09	Seanca 14	619	583	36	0.58
Shkurt-10	Seanca 15	1183	1094	89	0.92
Prill-10	Seanca 16	528	521	7	0.98
Qershor-10	Seanca 17	611	597	14	0.97
Gusht-10	Seanca 18	1007	974	33	0.98
Tetor-10	Seanca 20	339	324	15	4.6
Dhjetor-10	Seanca 20	174	171	3	1.75
Shkurt-11	Seanca 21	697	665	32	4.8
Maj-11	Seanca 22	406	404	2	0.5
Qershor-11	Seanca 23	645	636	9	1.4
Shtator-11	Seanca 24	911	875	36	4.1
Tetor-11	Seanca 25	820	816	4	0.4
Dhjetor-11	Seanca 26	632	619	13	1.9
Shkurt-12	Seanca 27	1005	925	55	0.6
Prill-12	Seanca 28	849	600	2	0.04
Qershor-12	Seanca 29	845	1022	13	0.01
Shtator-12	Seanca 30	1189	1161	20	0.01
Tetor-12	Seanca 31	735	734	8	0.01
Dhjetor-12	Seanca 32	625	615	4	0.003
Gjithsej të vendosura		38,261	36,012	2,158	
Të shfuqizuara			18,441		
Totali i përgjithshëm			17,571		

Shtojca C - Buxheti i AKP-së për vitin 2012

AKP - Buxheti i Donatorëve për 2012	kosto mujore	kosto vjetore	të zotuar	nevojat shtesë
	a	b=a*12	c	d=b-c
Totali:	141,836	1,704,896	1,285,965	418,931
Paga dhe Mëditje	83,318	1,002,688	897,693	104,995
pagat e stafit lokal	83,318	1,002,688	897,693	104,995
Mallra dhe Shërbime	19,054	228,646	151,491	77,155
Pagat e stafit jashtë Kosovës	10,804	129,648	86,432	43,216
Sigurimi shëndetësorë	4,725	56,700	33,628	23,072
Qiraja	1,324	15,888	13,240	2,648
Paratë e imëta	1,500	18,000	13,981	4,019
Tjera	701	8,410	4,210	4,200
Transferi për UNDP-në	31,036	372,433	186,217	186,217
UNV-të	8,427	101,130	50,565	50,565

shënime:

UNV-të - kostoja totale vjetore për dy UNV (2*41,756\$) dhe kostoja vjetore për vitin fillestar për një UNV (1*54,762\$).

Kostoja totale vjetore 138,274 \$/101,129.71 €

Mallrat dhe shërbimet tjera përfshijnë- transferet për UNHCR (4,200 for qiratë NI and KG dhe 4,210 për shpenzime tjera)

UNDP - 509,226 \$/372,433.26 € (1 \$ = 0.731371 €),

AKP - Buxheti i Kosovës 2012	kosto mujore	kosto vjetore	të zotuar	nevojat shtesë
	a	b=a*12	c	d=b-c
Totali:		2,066,833	1,756,761	310,072
Paga dhe Mëditje		951,223	951,223	0
Pagat e stafit lokal		888,675	888,675	0
Kontributi pensional i punëdhënësit		49,948	49,948	0
Anëtarët vendor të Bordit të AKP-së		12,600	12,600	0
Mallra dhe Shërbime		795,100	635,028	160,072
Shërbime Komunale		96,510	96,510	0
Investime Kapitale		224,000	74,000	150,000

AKP - Buxheti total 2012	kosto mujore	kosto vjetore	të zotuar	nevojat shtesë
	a	b=a*12	c	d=b-c
Totali i Donatorëve dhe BKK-së		3,771,729	3,042,726	729,003

Shtojca D - Buxheti i rishikuar i AKP-së për vitin 2012

AKP - Buxheti i Donatorëve për 2012	kosto mujore	kosto vjetore	Buxheti i reviduar	të zotuar	nevojat shtesë
	a	b=a*12	c	d	e=c-d
Totali:	141,836	1,704,896	1,650,196	1,650,196	-0
Paga dhe Mëditje	83,318	1,002,688	949,000	949,000	0
Pagat për stafin vendor	83,318	1,002,688	949,000	949,000	0
Mallra dhe Shërbime	19,054	228,646	243,284	243,284	0
Pagat e stafit jashtë Kosovës	10,804	129,648	118,908	118,908	0
Sigurimi shëndetësor	4,725	56,700	64,395	64,395	0
Qiraja	1,324	15,888	15,736	15,736	0
Paratë e imëta	1,500	18,000	24,787	24,787	0
Tjera	701	8,410	19,459	19,459	0
Transferi për UNDP-në	31,036	372,433	376,086	376,086	-0
UNV-të	8,427	101,130	81,826	81,826	0

Shënime:

UNV-të - kostoja totale vjetore për dy UNV (2*41,756\$) dhe kostoja vjetore për vitin fillestar për një UNV (1*54,762\$).

Kostoja totale vjetore 138,274 \$/101,129.71 €

UNDP - 509,226 usd/372,433.26 EUR (1 USD = 0.731371 EUR), buxheti i reviduar 376,086 EUR

Shuma prej € 23,537.88 është pjesë e fondeve të donatorëve të pranuar për periudhën Nëntor/Dhjetor 2012 të cilat janë planifikuar që të barten në 2013 prandaj nuk janë futur në këtë tabelë.

AKP - Buxheti i Kosovës 2012	kosto mujore	kosto vjetore	Buxheti i reviduar	të zotuar	nevojat shtesë
	a	b=a*12	c	d	e=c-d
Totali:		2,066,833	1,806,761	1,806,761	0
Paga dhe Mëditje		951,223	901,122	901,122	0
Pagat për stafin vendor		888,675	841,124	841,124	0
Kontribute pensionale		49,948	47,398	47,398	0
Anëtar vendor të Bordit të AKP-së		12,600	12,600	12,600	0
Mallra dhe Shërbime		795,100	702,052	702,052	0
Shërbime Komunale		96,510	133,601	133,601	0
Investime Kapitale		224,000	69,986	69,986	0

Të hyrat vetanake		42,632	42,632	16,694	25,938
--------------------------	--	---------------	---------------	---------------	---------------

AKP - Buxheti total 2012	kosto mujore	kosto vjetore	Buxheti i reviduar	të zotuar	nevojat shtesë
	a	b=a*12	c	d	e=c-d
Totali i Donatorëve dhe BKK-së		3,771,729	3,456,957	3,456,957	0

Shtojca E - Pasqyra e shpenzimeve të buxhetit të AKP-së për vitin 2012

Kodi Ekonomik	BKK	A	B	C	D=B-C	C/B
		Buxheti	Alokimi	Shpenzimet	Të pashpenzuara	Shpenzuar kundër buxhetuar (%)

	AKP Totali	1,806,761.00	1,806,761.00	1,746,044.86	60,716.14	96.64%
--	-------------------	---------------------	---------------------	---------------------	------------------	---------------

11100	Pagat dhe Mëditjet	901,122.00	901,122.00	898,925.16	2,196.84	99.76%
13000	Mallrat dhe Shërbimet	702,052.00	702,052.00	645,970.71	56,081.29	92.01%
13199	Shpenzimet Komunale	133,601.00	133,601.00	131,794.02	1,806.98	98.65%
30000	Shpenzimet Kapitale	69,986.00	69,986.00	69,354.97	631.03	99.10%

22	2011 Të Hyrat Vetanake	16,694.00	16,694.00	11,159.56	5,534.44	66.85%
21	2012 Të Hyrat Vetanake	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00%


Kodi Ekonomik	Donatorët	A	B	C	D=B-C	C/B
		Buxheti	Alokimi	Shpenzimet	Të pashpenzuara	Shpenzuar kundër buxhetuar (%)

	AKP Totali	1,673,733.93	1,673,733.93	1,630,728.67	43,005.26	97.43%
--	-------------------	---------------------	---------------------	---------------------	------------------	---------------

11100	Pagat dhe Mëditjet	952,563.63	952,563.63	942,619.58	9,944.05	98.96%
13000	Mallrat dhe Shërbimet	721,170.30	721,170.30	688,109.09	33,061.21	95.42%
13200	Shpenzimet Komunale	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00%
30000	Shpenzimet Kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00%

Komuna	Të iniciuara nga HPD (ex officio)	Paraqitësi i Kërkesës HPCC:	Kërkesës e Paraqitësit të Kërkesës i KKPK-së
Gjithsej	410	2174	5602
MITROVICË	94	658	1008
Leposaviq	0	0	5
Mitrovicë	44	558	119
Skënderaj	0	23	518
Vushtrri	50	50	327
Zubin Potok	0	10	39
Zveçan	0	16	0
GJILAN	94	169	1427
Gjilan	56	18	221
Kamenicë	29	3	142
Kaçanik	0	15	58
Novobërdë	0	7	230
Shtërpçë	1	1	12
Ferizaj	1	91	424
Viti	7	34	340
PEJË	110	872	2040
Gjakovë	14	258	90
Deçan	12	245	65
Klinë	7	31	598
Istog	17	101	976
Pejë	61	237	311
PRISHTINË	90	263	526
Glllogoc	0	2	0
F.Kosovë	5	25	16
Lipjan	10	17	114
Obiliq	22	66	44
Podujevë	0	22	231
Prishtinë	47	124	86
Shtime	5	8	35
PRIZREN	22	212	601
Dragash	0	4	0
Malishevë	0	0	94
Rahovec	0	25	66
Prizren	21	128	266
Suharekë	1	55	175

STRUKTURA ORGANIZATIVE E AKP-SË





KOSOVO PROPERTY AGENCY
AGJENCIA KOSOVARE E PRONËS
KOSOVSKA AGENCIJA ZA IMOVINU

Raporti Vjetor 2012

Selia:

Perandori Justinian 5, Qyteza Pejton, 10000, Prishtinë
Tel: +381 (0)38 249-918, Fax: + 381 (0) 38 249 919

Prishtinë

Rexhep Luci 2, 10000 Prishtinë
Tel: +381 (0) 38 225 473, Fax: +381 (0) 38 244 854
Graçanicë
Rruga kryesore Prishtinë - Gjiilan,
50m pas urës në anën e djathtë të rrugës.

Prizren

"Jeronim De Rada" Nr: 74 (mbrapa qendres tregtare - Ben Af)
20 000, Prizren
Tel: +381 (0) 29 231 469, +381 (0) 29 231 429

Gjiilan

Lidhje e Prizrenit 114, 60 000, Gjiilan
Tel: 0280 320 289, Fax: 0280 324 067

Mitrovicë

Mbretëresha Teuta (përballë Jugobankës)
40 000, Mitrovicë
Tel: + 381 (0) 28 530 136/7
Jug: Rr. Mbretëresha Teuta (përballë ish- Jugobankës)
Veri: Rr. Filip Vishnjq, Ndërtesa e TREPÇËS, zyra nr. 18
Tel: 065 577-8-550

Pejë

Mbretëresha Teuta 85, 30 000, Pejë
Tel: +381 (0) 39 431 668, Fax: +381 (0) 39 432 970

Podgoricë

Crnogorskih Serdara bb, 81 000, Podgoricë
Tel: +382 (0) 20 624 216

www.kpaonline.org